



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Këshilli Kombëtar i Integrimit Europian

Takim periodik i Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.5.2022, ora 12.30

Drejton mbledhjen - Jorida Tabaku

Rendi i ditës:

1. Mirëseardhja dhe fjalët përshëndetëse nga Znj. Jorida Tabaku, Kryetare e Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian dhe Z. Taulant Balla, Nënkyetar i Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian.
2. Ecuria në luftën kundër korrupsionit dhe zbatimi i rekomandimeve të Komisionit Europian në Raportin e vitit 2021 për Shqipërinë, si dhe Nënkomitetit BE-Shqipëri për Drejtësi, Liri dhe Siguri 2021.
3. Diskutime nga pjesëmarrësit.
4. Mbyllja e takimit.

Marrin pjesë:

Jorida Tabaku, Taulant Balla, Toni Gogu, Gazment Bardhi, Mimi Kodheli, Klotilda Bushka, Dhurata Çupi, Eduart Ndreca, Nasip Naço, Xhemal Qefalia, Eduard Shalsi, Sorina Koti, Blerina Gjylameti, Klodiana Spahiu, Arben Pëllumbi, Helidon Bushati, Fadil Nasufi, Petro Koçi, Etilda Gjonaj, Ilda Zhulali, Olsian Çela, Fatbardh Zenelaj përfaqësues nga Avokati i Popullit, Alban Dafa përfaqësues nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Iris Shima përfaqësues nga Qendra ALTRI, Gledis Gjipali, Edison Hoxha, Granit Sokolaj, përfaqësues nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit Erdion Meçolli, Besnik Dervishi, Pranvera Strakosha, Robert Gajda, Mirela Gega, Ilir Kalemaj, Ilir Xhemalaj, Marsida Gjonçaj.

Të ftuar:

Ulsi Manja - Ministër i Drejtësisë.

Olsian Çela - Prokuror i Përgjithshëm.

Arben Kraja, Drejtues i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

HAPET MBLEDHJA

Jorida Tabaku - Të nderuar kolegë,

Të nderuar të ftuar, zoti Manja, Ministër i Drejtësisë, zoti Çela prokuror i Përgjithshëm, zoti Kraja drejtues i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, kolegë deputetë, anëtarë të Këshillit Kombëtar të Integritimit,

Së pari, më lejoni që t'ju falënderoj për pjesëmarrjen në mbledhjen e dytë raportuese të Këshillit Kombëtar të Integritimit në lidhje me prioritet, duke qenë se qershori do të jetë një muaj i ngarkuar edhe me vendime, të cilat lidhen me hapjen e Konferencës së Parë Ndërqeveritare. Ne kemi menduar të organizojmë një seksion dëgjësash me të gjitha institucionet, që lidhen me zbatimin e secilit prej parakushteve, por njëkohësisht edhe me prioritetet, të cilat janë vendosur për sa i përket hapjes së konferencës së parë.

Unë, shkurtimisht, do të bëj disa komente të përgjithshme dhe më pas do të hapim seancën për të ftuarit, për pyetje dhe diskutime njëkohësisht me anëtarët e nderuar të këtij Këshilli.

Dua ta nis me luftën ndaj korrupsionit, cilat janë rekomandimet e kapitullit 23, “Gjyqësori dhe të drejtat e njeriut”, por njëkohësisht edhe me disa elemente që lidhen me punën e prokurimit publik. Porgres raporti thotë se Shqipëria ka një nivel përgatitjeje për luftën ndaj korrupsionit. Shqipëria ka bërë përpjekje për të krijuar një sistem gjurmimi solid në luftën kundër korrupsionit, megjithëse mbetet një objektiv që kërkon vullnet politik dhe veprimet konkrete të mëtejshme të strukturuar. Dënimet në rastet që përfshijnë zyrtarët në nivelin të lartë mbeten ende të kufizuara, duke nxitur një kulturë mosndëshkimi brenda niveleve më të larta të shtetit. Strukturat e specializuara kundër korrupsionit, SPAK, por njëkohësisht dhe gjykata kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, duhet të forcojnë ndjeshëm kapacitetin e përgjithshëm të vendit për të hetuar dhe ndjekur penalisht korrupsionin.

Ka një sërë rekomandimesh, që vijnë në këtë drejtim, të cilat janë: të vijohet me fuqizimin e luftës ndaj korrupsionit; të bëhet më shumë progres në atë që ne e kemi quajtur “*track record*-historik hetimesh”; të garantohet që struktura e posaçme, që do të thotë jo vetëm prokuroria, por njëkohësisht edhe gjykata, edhe BKH-ja të adresojnë me efikasitet korrupsionin në nivelet e larta; të garantohet se procedimet penale iniciohen në mënyrë të vazhduar dhe njëkohësisht adresimet e GREKO-s; të punohet për sa i përket historikut të të dhënave dhe gjurmimit të rasteve, të cilat shkojnë që nga momenti kur ngrihet një akuzë, deri te dënimi përfundimtar, që unë besoj se ka qenë një nga vërejtjet e vazhdueshme të porgresraportit; të rriten dënimet e formës së prerë në çështjet e nivelit të lartë, që mbetet ende një prioritet.

Në përgjithësi, fatkeqësisht, korrupsioni mbizotëron në shumë fusha të jetës publike dhe atë të biznesit dhe mbetet një problem serioz. Ndikimi i masave kundër korrupsionit, veçanërisht në fushat vulnerabil, si doganat, administrim tatimesh, arsim, shëndetësi, prokurime publike, mbetet i kufizuar.

Unë e di, e kemi dëgjuar të gjithë shpesh që lufta ndaj korrupsionit as nuk nis dhe as nuk mbaron në një ditë të caktuar, është një proces. Unë besoj se, që ky proces të jetë dinjitoz dhe të jetë me rezultate konkrete, u takon këtyre 3 institucioneve që kemi thirrur sot, që të na tregojnë atë mbështetje politike që u kemi dhënë me votë dhe me ngritjen, në mënyrë të veçantë të SPAK-ut në Parlament, ta përkthejmë në rezultate të konsiderueshme dhe njëkohësisht në rezultate domethënëse në hetimin ndaj korrupsionit.

Këtu ka disa fjali për sulmet politike që kanë ndodhur ndaj SPAK-ut dhe institucioneve të pavarura të drejtësisë kohëve të fundit. Fatkeqësisht, kur pushteti nuk të kontrollon dot, të sulmon. Fatkeqësisht, ndodh që sa herë ka një problem, sulmohet, kur duket që po shkohet në drejtimin e duhur. Unë kam përshtypjen që hetimet ndoshta po shkojnë në drejtimin e duhur, ndoshta disa nga institucionet po e bëjnë punën mirë, për këtë arsye janë rritur edhe sulmet politike.

Zoti Manja, zoti Ministër i Drejtësisë, dua të ngre shqetësimin si deputete e këtij Parlamenti, por njëkohësisht edhe si kryetare e Komisionit të Integritetit, se një nga prioritetet kyç dhe elementet kyçe që përmendet në çdo progres raport është ndarja e politikës nga vendimmarrja e gjyqësorit, mosndërhyrja në vendimmarrjen e gjyqësorit, mosndërhyrja në rastin e hetimeve ndaj korrupsionit, pavarësia *check and balance*...

(Ndërpritet audio dhe video)

...që përdorin pushtetin për të sulmuar sa herë që nuk na pëlqejnë rezultatet...

(Ndërpritet audio dhe video)

... hetimet e institucioneve që unë dua t'i falënderoj, se i kam lexuar me shumë interes...

(Ndërpritet audio dhe video)

... FATF për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve për të gjitha detyrimet që ka qeveria shqiptare si rezultat i vendosjes në Listën Gri të pastrimit të parave. Në lidhje me këtë gjatë vitit 2021, institucionet raportojnë se janë hetuar 316 materiale pasurore, janë paraqitur dhe miratuar nga gjykata 14 kërkesa për sekuestrimin e pasurive. Pra, nga 316 materiale pasurore kemi vetëm 14 kërkesa për sekuestrim dhe nga këto vetëm 4 për konfiskim. Ku çalon problemi? Pse lufta për pastrimin e parave të krimit dhe të drogës sot nuk është efektive? Pse Shqipëria vazhdon mbetet në Listën Gri?

Dhe elementi i fundit, tek i cili dua të ndaloj, për të cilin shpresoj që edhe përfaqësuesit e institucioneve të na ndihmojnë me përgjigje, është hetimi financiar. Çfarë po ndodh me hetimin financiar? A kanë institucionet e reja të ngritura ose të vjetra të sistemit të drejtësisë kapacitetin e tyre për të forcuar hetimin? A ka sot SPAK-u një drejtor ose një njësi që merret me hetimin financiar, me hetimin pasuror 2 vjet e gjysmë nga ngritja e tij? A kanë mjaftueshëm kapacitete, burime financiare, njerëzore për luftën ndaj korrupsionit, pastrimin e parave dhe për hetimi pasuror të të gjithë individëve të përfshirë në kuadër të hetimeve që ata janë duke ndërmarrë?

Këto janë disa nga elementet të cilat unë dua të përmend, për të cilat besoj se do të kenë pyetje edhe kolegët. Janë disa elemente me një rëndësi të veçantë, besoj edhe për opinionin publik, por më e rëndësishmja është për procesin e integritetit. Unë e kam thënë që në krye të herës, kur është mbledhur ky Këshill, që procesi i integritetit është një proces transformues, pak rëndësi ka vjen apo nuk vjen data. Çfarë bëjmë ne për të shkuar te ky proces? Çfarë rezultatesh kemi ne? Këto 3 elemente, hetimi i krimit zgjedhore, së pari, lufta ndaj korrupsionit, parave të krimit dhe të drogës, sekuestrimi i pasurive dhe së treti, mbështetja e këtyre institucioneve në bërjen e punës së tyre të pavarura, të pandikuar nga sulmet politike, besoj se është në integritetin e këtij Këshilli t'ia kërkojë qeverisë, t'ia kërkojë Parlamentit, por edhe për t'i inkurajuar në punën e tyre.

Faleminderit!

Fjalën do t'ia jap zotit Balla, bashkëkryetar i këtij Këshilli.

Taulant Balla – Zonja dhe zotërinj,

Të nderuar të ftuar,

Ky është Këshilli Kombëtar i Integritimit European, ku të gjitha institucionet bëhen bashkë për të rakorduar qëndrimet e përbashkëta në këtë proces të rëndësishëm historik. Ne presim që në fund të qershorit të mbajmë Konferencën e Parë Ndërqeveritare Shqipëri – BE. Edhe dje përfaqësuesja e Francës në Shqipëri, e cila erdhi këtu në Kuvend, na garantoj për gatishmërinë e presidencës aktuale të Bashkimit European, për ta zhvilluar konferencën e parë. Sesa do të zhvillohet, nuk varet më aspak nga ne, por përgatitja dhe adresimi në kohë i detyrave të shtëpisë është shumë themelor në këto javë dhe në muajt në vijim.

Ne jemi këtu për të adresuar çështje që lidhen me kapitullin 23, “Gjyqësori, të drejtat e njeriut”. Natyrshëm lufta kundër korrupsionit, krimin të organizuar mbeten çështje tepër të rëndësishme. Unë dua të jem shumë konkret dhe ftoj të gjithë kolegët që ky raportim të mos u ngjajë raportimeve ndër vite, ku institucionet vijnë, mbajnë një fjalim dhe ikin, por ky raportim duhet të jetë i fokusuar në çështje konkrete dhe me pyetje konkrete. Nuk është nevoja për shumë diskutime, por për pyetje direkte dhe për përgjigje direkte. Nëse përfaqësuesve do t’u duhet kohë, le të marrin kohën e duhur, kurse Kuvendi i Shqipërisë të programojë takimin e radhës ku të merren të gjitha përgjigjet.

Tani do të flas për gjëra konkrete. Nuk do të mbaj një diskutim të gjatë, por do t’ju them thjesht dhe vetëm çfarë duhet të raportohet sot.

Sot duhet të raportohet për mënyrën si janë adresuar 4 rekomandimet, që lidhen me fuqizimin e luftës kundër korrupsionit, me kulturën e mosndëshkimit ndër vite në nivelet e larta, me garantimin me efikasitet të luftës kundër korrupsionit dhe, ajo që është më e rëndësishme për mua dhe që në raportim nuk e gjeta të adresuar si duhet dhe prandaj do ta shtroj si pyetje, të garantohet se procedimet penale iniciohen në mënyrë të vazhduar dhe sistematike ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të akuzuar për sjellje kriminale gjatë procesit të rivlerësimit. Kjo është detyra e shtëpisë që ka Shqipëria.

A e kemi përmbushur ne këtë detyrë? Në pikën 2 të raportimit, që është edhe pika 3 e detyrave, më rezulton se nuk jemi aty ku duhet. Shqipëria nuk ka ende një listë të plotë të ish-gjyqtarëve, ish-prokurorëve dhe ish-magjistratëve, të cilët janë shkarkuar nga vetingu, sepse kanë rezultuar me mospërputhje tepër të mëdha të gjendjes së tyre të pasurisë dhe asaj që kanë deklaruar si të përfituar në mënyrë ligjore dhe që për të cilën duhet që hetimet të jenë të forta.

Numri i asaj që raportohet është shumë i vogël me numrin e magjistratëve të shkarkuar, me disproporcion të tmerrshëm pasurie.

Natyrshëm, nëse unë do të isha një zyrtar i Brukselit, kur të shikoja këtë nivel raportimi, do të thosha “Shqipëria nuk e ka adresuar këtë rekomandim”. Kjo është e qartë. Ne nuk mund të themi që prokuroria nuk mund të fillojë vetë hetime kryesisht. Unë mendoj se duhet të fillojë edhe hetime kryesisht. Ne nuk mund të themi se e ka fajin ILDKPI-ja që nuk ka bërë kallëzime apo e kanë fajin organet e vetingut. Kjo është e para dhe besoj se do të adresohet në përgjigje.

E dyta, kur ne si ligjvënës kemi dizenuar këtë formë të re të organeve të luftës kundër korrupsionit me prokurorinë speciale, e kemi marrë si model në vendet që ka funksionuar; i jemi referuar tërësisht modelit rumun, DNA-së së tyre. Nuk ka asnjë dallim, është e njëjta. Arsyeja pse u ngrit një strukturë e tillë është për të hetuar të gjitha çështjet e mëdha që kanë krijuar kulturën e mosndëshkimit.

Pyetja ime, zoti prokuror i Përgjithshëm, zoti drejtues i Prokurorisë së Posaçme është: pse Prokuroria e Posaçme nuk e heton 21 janarin? Pse Prokuroria e Posaçme nuk bën transparente çfarë po ndodh me korrupsionin në Gërdec? Vrasja në Gërdec është një tjetër gjë dhe korrupsioni që shkaktoi tragjedinë e Gërdecit është gjë shumë më e madhe në kuptimin e pazbulueshmërisë, e kulturës së mosndëshkimit.

E treta, që për mua është e rëndësishme dhe që do ta quaja një ndër pyetjet themelore, është: çfarë opinioni ka prokuroria shqiptare për *non grata*-n?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta mbaroj. Patjetër.

Sepse lidhet me pikën 3, me mosndëshkimin brenda niveleve të larta.

Zonja dhe zotërinj prokurorë të Republikës së Shqipërisë, Shtetet Bashkuara të Amerikës e kanë përcaktuar publikisht Sali Berishën, ish-President i Shqipërisë, ish-Kryeministër, ish-deputet i Kuvendit të Shqipërisë, për shkak të përfshirjes së tij në korrupsion të konsiderueshëm ...

Jorida Tabaku – Zoti Balla!

Taulant Balla – Ta mbaroj.

Jorida Tabaku – Mbaroje, por të fokusohemi te çështja e procesit të integritetit.

Taulant Balla – Patjetër, kjo lidhet me procesin e integritetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të respektojmë njëri-tjetrin.

Ruani qetësinë, sepse kjo është gjëja më e rëndësishme që unë mendoj se e kemi detyrim ndaj shqiptarëve.

Unë besoj se Shqipëria, si një vend që Shtetet e Bashkuara të Amerikës i konsideron partnerin e tyre strategjik, duhet t'i marrë seriozisht dokumentet zyrtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Në cilësinë e tij si zyrtar, si Kryeministër i Shqipërisë, sipas Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Sali Berisha është përfshirë në veprime korruptive, të tilla si: shpërdorimi i fondeve publike, ndërhyrje në procese publike, duke përfshirë përdorimin e pushtetit për përfitime personale (shpërdorim detyre, thotë Kodi Penal në Republikën e Shqipërisë), për të pasuruar aleatët e tij politikë dhe anëtarët e familjes së tij. Pjesa tjetër ishte për korrupsion.

A ka regjistruar prokuroria shqiptare ndonjë procedim penal kryesisht për këtë? A i ka çuar prokuroria shqiptare ndonjë letër apo letër-porosi Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Departamentit Amerikan të Shtetit, ku ta pyesë nëse kanë dokumentacion, sepse ata e kanë bazuar këtë në seksionin nr. 7031 të Departamentit të Shtetit “Operacionet e Jashtme, dhe Programeve të Ndarjeve të Programeve”, ku kanë të gjithë dosjen përkatëse?

Prandaj, kredibiliteti ynë dhe këtu do ta mbyll zonja kryetare, sepse të kuptoj ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, kush jeni ju?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta mbaroj unë?

Natyrshëm, vura këtë, sepse një *non grata* tjetër është hetuar nga prokuroria dhe ne jemi këtu edhe për t'i thënë “bravo” kur kanë bërë punën. Kemi rastin e ish-prokurorit të Përgjithshëm, për hetimin e të cilit është bërë puna. Standardi, meqë ma kërkua, nuk duhet të jetë i dyfishtë.

Kështu që, në këtë këndvështrim, unë mendoj se ky raportim duhet të jetë konkret dhe jo me diskutime, gjë për të cilën jemi të gjithë dakord.

Natyrshëm, jo në cilësinë e drejtuesit të Këshillit Kombëtar të Integritetit, do t'u kërkoja të gjitha komisioneve përgjegjëse që rezolutat që miratojnë në Kuvendin e Shqipërisë, të mos jenë vetëm histori me përshëndetje, sepse nuk është nevoja fare t'i përshëndesim institucionet

(nuk flas për këto që janë sot këtu), por t'i bëjmë raportim konkret, që kur të vijë vitin tjetër për raportim, të shikojmë janë bërë, apo jo?

Edhe një herë, dua të shpreh mbështetjen e fortë të Kuvendit të Shqipërisë në luftën kundër korrupsionit dhe mbështetjen e fortë të shumicës parlamentare ndaj institucioneve të pavarura që të bëjnë detyrën e tyre. Të kërkosh të zbatohet ligji dhe luftohet korrupsioni, nuk është sulm, por është mbështetje.

Mbështetja jonë nuk ka për të munguar dhe të gjithë zotërinjtë që janë këtu e dinë fare mirë që sa herë kanë pasur kërkesa për mbështetjen e tyre, edhe buxhetore, nga Kuvendi i Shqipërisë, se ky është institucioni i duhur, ne nuk kemi reshtur së mbështeturi, sepse mendojmë që reforma në drejtësi, ajo që kemi nisur në vitin 2016 dhe që po vazhdojmë, është gjëja e duhur për Shqipërinë dhe për ta bërë Shqipërinë anëtare të Bashkimit Europian.

Kështu që, edhe një herë, zonja kryetare, faleminderit edhe për fjalën tuaj!

Ju thatë mendimin tuaj, unë thashë mendimin tim, kurse tani të fillojmë raportimin.

Jorida Tabaku - Zoti Balla, unë shpresoja se do t'i kursenim anëtarët e Këshillit Kombëtar të Integritimit me luftën politike të ditës dhe sot do të diskutonim për çështje të rëndësishme që lidhen me këtë proces.

Unë shpresoj shumë që të njëjtat mendime që ndatë për një deputet të parlamentit të Shqipërisë, t'i ndani edhe për personat *non grata* nga ana e Partisë Socialiste dhe njëkohësisht të merrni masat përkatëse, duke qenë se shpallja lidhet me krime zgjedhore.

Unë i lexoj raportet e Departamentit të Shtetit, por duhet t'i lexoni ju së pari. Shpresoj shumë që kjo thirrje që iu bë SPAK-ut sot të vazhdojë t'i bëhet për raste, të cilat janë më interes publik. Ndoshta kam konflikt interesi të përmend rastin e insineratorëve, por besoj se ajo është një nga aferat dhe çështjet që ka nevojë të vazhdojë të hetohet.

Dua t'u kërkoj ndjesë anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Integritimit Europian, duke qenë se zoti Balla e çoi diskutimin aty ku do pushteti, dhe të rikthehem në çështjet që i interesojnë Këshillit Kombëtar të Integritimit, te raportimi i institucioneve.

Edhe një herë, përmbledhurazi, për ministrin e Drejtësisë, që do të flasë tani: zoti Manja, unë e di që pushteti sot i ka të gjitha në dorë. Mendoni se thirrjet e fundit që keni bërë drejtuar institucioneve të pavarura të drejtësisë kanë shërbyer për luftën ndaj korrupsionit? Nuk janë ato një sinjal i faktit që hetimet po shkojnë në drejtimin e duhur? Nuk janë ato një sinjal i faktit që nuk po i kontrolloni këto institucione dhe po i sulmoni? Unë shpresoj shumë që si

ministër i Drejtësisë të keni, të paktën, nuk po them çiltërsinë ose naivitetin, drejtësinë për t'i folur këtij Këshilli Kombëtar të Integritimit ashtu siç i duhet folur dhe adresuar.

Në gjykimin tim, qeveria shqiptare, bashkë me institucionet e pavarura të Shqipërisë ka 17 institucione për luftën ndaj korrupsionit. Një çoroditje e tillë institucionale nuk ekziston në asnjë sektor tjetër. Lufta ndaj korrupsionit, që është si koordinator ministri i Drejtësisë sot, nuk i ka strukturat përkatëse të ngritura nëpër ministri. Ministri i Drejtësisë ka një konflikt interesi në luftën ndaj korrupsionit, duke qenë se ai vetë drejton institucione që varen me luftën ndaj korrupsionit. Unë gjykoj që strategjia e ndjekur nga qeveria shqiptare me plane integriteti nuk shkon, sepse sot, fatkeqësisht, si në rastin e inceneratorëve, korrupsioni është me kostum, korrupsioni bëhet me ligj, korrupsioni ulet në qeveri dhe zoti Manja ka një konflikt interesi në këtë drejtim. Shpresoj që në prezantimin tuaj të fokusohemi në gjërat që kanë rëndësi për progresraportin.

U kërkoj ndjesë kolegëve në qoftë se do t'juja ndërpres fjalën 5-7 minuta.

Faleminderit!

Ulsi Manja – E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar anëtarë të Këshillit Kombëtar të Integritimit,

Në fakt, unë mendoj se sot është vendi i duhur, ku duhet të flasim ne që na keni thirrur për të raportuar këtu dhe që jemi të hapur. Unë, personalisht, si ministër i Drejtësisë dhe Koordinator Kombëtar i luftës Kundër Korrupsionit jam i gatshëm t'i përgjigjem çdo lloj pyetjeje që do të adresohet nga këto kolegë shumë të nderuar të këtij Këshilli, sot, nesër, po dhe në çdo moment që ju do të na kërkon.

E konsideroj vendin e duhur për të shkëmbyer bashkërisht përpjekjet për të luftuar korrupsionin, jo vetëm për të vendosur themelet e një administrate me integritet, por për të përgatitur vendin për procesin jetik të negociatave me Bashkimin Europian.

Në fakt, këtu në formën e diskutimit u shtruan edhe disa pyetje lidhur me sinjalet që ne, si maxhorancë, por dhe unë, si ministër i Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar, gjatë këtyre ditëve kemi bërë në adresë të agjencive përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit. Po, fakti që jemi sot në një tryezë të gjithë bashkë këtu në Këshillin Kombëtar të Integritimit është sinjal i qartë i bashkëpunimit dhe i vullnetit tonë për të bashkëpunuar dhe për të çuar përpara luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe agjendën e Shqipërisë drejt Bashkimit Europian.

Komisioni European në këtë proces është vëzhguesi më objektiv i punës tonë për avancimin e agjendës Europiane të Shqipërisë dhe ka konsideruar në vijimësi se Shqipëria sot ka përmbushur kushtet për mbajtjen e konferencës së parë ndërqeveritare. Këtë e thotë Komisioni European. Ky vlerësim, natyrisht, ndër të tjera, është fryt i punës intensive disavjeçare të kësaj maxhorance, por jo vetëm të kësaj maxhorance, për të vënë në jetë reformën në drejtësi, për të mbështetur ngritjen dhe konsolidimin e një prej shtyllave më kritike të reformës, kuadrin institucional në funksion të kësaj lufte kundër korrupsionit, që është SPAK-u dhe Gjykata e Posaçme.

Krahas mbështetjes së luftës kundër korrupsionit në kuadër të reformës në drejtësi, qeveria shqiptare ka ndërmarrë hapa solide për të fuqizuar të gjithë kuadrin institucional dhe rregullator në luftën kundër korrupsionit, përfshirë këtu edhe forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve të Ministrisë së Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit. Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e institucionit lider për kapitullin 23, ku përfshihet gjyqësori dhe të drejtat themelore, por edhe nënkaptulli i antikorrupsionit, ka koordinuar dhe monitoruar procesin e zbatimit të rekomandimeve të Komisionit European për Shqipërinë vit pas viti. Në sajë të raporteve periodike që institucionet publike dërgojnë pranë Ministrisë së Drejtësisë, ne kemi sot një pasqyrë të qartë të shkallës së zbatimit të këtyre rekomandimeve nga të gjitha institucionet përgjegjëse, anëtare të grupit institucional të punës për kapitullin 23. Zbatimit të rekomandimeve në kuadër të luftës kundër korrupsionit i kemi shtuar vëmendje të shtuar edhe për shkak të prioritizimit të luftës kundër korrupsionit përmes përfshirjes së kapitullit 23 në grupin e kapitujve themelorë, që do të hapet i pari dhe që do të mbyllet i fundit.

Në raportin e fundit të Komisionit European për Shqipërinë, atë të vitit 2021, citohet shprehimisht: “Shqipëria ka një nivel përgatitjeje në luftën kundër korrupsionit. Është bërë progres në luftën kundër korrupsionit. Zbatimi i strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit në përgjithësi është në rrugën e duhur. Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve po sjell rezultate në luftën kundër korrupsionit. Krijimi i një rrjeti koordinatorësh kundër korrupsionit në 17 institucione është një hap pozitiv në luftën kundër korrupsionit. SPAK-u kontribuoi në përmirësimin e sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve kriminale në rastet e lidhura me korrupsionin”. Këto thotë Komisioni European në progresraportin e vitit 2021.

Rekomandimet e këtij progresraporti konsistojnë në këto drejtime: në forcimin e kuadrit ligjor, institucional e strategjik kundër korrupsionit, krijimin e një historiku solid të dënimit të krimit të korrupsionit, përfshirë këtu edhe rastet e magjistratëve të larguar nga vetingu, fuqizimin e kapaciteteve të SPAK-ut dhe adresimin e rekomandimeve të GRECO-s. Ne kemi ardhur këtu të raportojmë sot në Këshillin e Integritimit European si ne i kemi përmbushur rekomandimet e Komisionit European të lëna në progresraportin e vitit 2021 në këto drejtime që ata kanë bërë rekomandime. Më lejoni t'i marr më radhë, nëse do të kem kohë, sepse një pjesë e përgjigjeve mund të jepen dhe nëpërmjet pyetjeve.

Për sa i përket forcimit të kuadrit ligjor dhe institucional. Qeveria Shqiptare ka krijuar të parën drejtori të përgjithshme për antikorrupsionin, me qëllim garantimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse në drejtim të hartimit të politikave në fushën e korrupsionit, si dhe kryerjen e hetimeve administrative efektive për të luftuar korrupsionin në administratën publike. Krijimi i kësaj drejtorie antikorrupsion në Ministrinë e Drejtësisë ka forcuar kapacitetet e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, si dhe ka adresuar rekomandimet e një pas njëshme të raporteve të Komisionit European, por dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare, që kanë kërkuar krijimin e një autoriteti kryesor për qendëzimin e kompetencave në fushën e antikorrupsionit. Lidhur me drejtorinë, kjo drejtori sot është rritur në mënyrë eksponenciale. Kjo agjenci është krijuar më vendim të Këshillit të Ministrave në muajin tetor të vitit 2021 dhe ka një strukturë me 107 persona të dedikuar në luftën kundër korrupsionit, nga të cilët 27 në drejtorinë e përgjithshme, që janë rekrutuar mbi bazën e ligjit për shërbimin civil dhe 80 në institucionet ku kemi koordinatorë kombëtarë kundër korrupsionit. Në këto 6 muaj që flasim, njësia përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë nga 27 që duhet të ketë ka 20 të plotësuar, ndërsa në pozicionin e koordinatorit nga 80 që do të duhet të jenë në të gjitha agjencitë qeveritare, janë emëruar 24 koordinatorë dhe plotësimi është në proces e sipër. Krahas forcimit të kapaciteteve me burime të shtuara njerëzore për këto drejtori është mundësuar dhe një trajtim i posaçëm financiar për stafin e kësaj drejtorie. Këshilli i Ministrave ka dedikuar në funksion të kësaj drejtorie të përgjithshme antikorrupsion për vitin 2021 dhe në vazhdim 1.4 milionë euro, përfshirë këtu dhe një sistem të gjurmimit dhe të menaxhimit të denoncimeve të ardhura nga qytetarët, pa llogaritur kontributin që kanë dhënë partnerët ndërkombëtarë, të cilët na kanë mbështetur dhe vijojnë të na mbështesin në luftën kundër korrupsionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ulsi Manja – S`ka problem...

Jorida Tabaku- Do të bëjmë edhe pyetje, por të mos i ezaurojmë të gjitha gjërat...

Ulsi Manja – Ju na keni thirrur të raportojmë, unë e ndërpres kur të doni.

Jorida Tabaku – Jo, duhet t`i sintetizojmë pak, besoj.

Ulsi Manja –Lidhur me rrjetin e koordinatorëve kundër korrupsionit, ka qenë në 17 agjenci, ndërsa pas VKM-së së muajit tetor do të jetë në 44 institucione të vlerësuara me risk ndaj korrupsionit.

Lidhur me historikun solid të rezultateve të kësaj strukture, sepse, në fund te ditës, shqiptarët do të duan të dinë, nëse krijimi i kësaj drejtorie të përgjithshme antikorrupsion ka ndonjë rezultat konkret në kaq pak muaj jetë që ka. Po, janë marrë 152 masa administrative të propozuara për një sërë institucionesh, pjesë e rrjetit të koordinatorëve, masa disiplinore për nëpunës të lartë ekzekutiv, deri edhe në shkarkim të nëpunësve të nivelit të lartë drejtues; 21 kallëzime për ndjekje penale për nëpunës të nivelit ekzekutiv, si dhe për nëpunës të nivelit të lartë drejtuar prokurorive përkatëse, për të vijuar me ndjekjen dhe hetimin e çështjeve të dyshuara për kryerjen e veprave penale, rezultatet e deritanishme. Nëse do të flasim se çfarë kemi aktualisht në dorë, dua thjesht t`ju bëj me dijeni, sepse do të kemi raste të tjera që do t`i bëjmë publike, kanë përfunduar 350 praktika të denoncuara si korruptive, nga ku priten të gjenerohen raporte për rekomandime për masa administrative, por edhe për kallëzime penale; kjo është për sa i përket Drejtorisë Antikorupsion. Në lidhje me një rekomandim tjetër për forcimin e procesit ligjbërës, sepse ju e thatë pak më parë që korrupsioni është edhe ligjor, një nga rekomandimet e progresraportit për vitin 2021 ka qenë adresimi si duhet i atij që korrupsion ligjor, pra korrupsioni në procesin e ligjbërjes. Do të thoni ju çfarë kemi bërë ne për forcimin e procesit të ligjbërjes dhe eliminimin e hapësirave korruptive legjislativë?! Po, me urdhër të ministrit të Drejtësisë kemi miratuar manualin standard për hartimin e legjislacionit, ku parashikohen shprehimisht hapa për kontrollin paraprak të mundësive korruptive në ligj. E kemi hartuar me misionin Euralius dhe manuali për hartimin e legjislacionit është standard dhe duhet të ndiqet nga të gjitha ministritë e linjës, por jo vetëm, në procesin e hartimit të legjislacionit. Shkelja, anashkalimi i hapave dhe standardeve, që përcakton ky manual, vlerësohet se mund të lërë shkak dhe premisa për korrupsion ligjor. Nëse do të vazhdojmë pastaj me përpjekjet tona në drejtim të luftës për parandalimin e korrupsionit përmes digjitalizimit, revolucion digjital, është mundësuar disafishimi i numrit të shërbimeve publike të ofruara *online*. Unë nuk po hyj t`i

përmend shifrat për vitin 2021, sepse ju e dini tashmë që nga 1 maji në Shqipëri janë mbyllur të gjitha sportelet dhe shërbimet për qytetarët ofrohen *online*. Do të thoni ju si ka ndikuar digjitalizimi për të luftuar korrupsionin?! I ka dhënë impuls parandalimit të korrupsionit, jo vetëm se ka reduktuar korrupsionin në sportele përmes shmangies tërësore të kontaktit fizik me ofruesin e shërbimit, por, mbi të gjitha, na ka dhënë mundësi ne të gjurmojmë abuzimet për të lehtësuar identifikimin e abuzuesve me funksionet publike brenda administratës. Tashmë e kemi shumë të lehtë ta identifikojmë brenda administratës se kush abuzon me funksionet publike, dhe këtë na i ka krijuar digjitalizimi, teknologjia.

Për sa i përket rekomandimit për forcimin e kuadrit strategjik, Ministria e Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit, është përgjegjëse për monitorimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit.

Unë do të ndalem jashtëzakonisht shkurt në tri aspektet e punës sonë në këtë drejtim: qasja parandaluese, qasja ndëshkuese, dhe këtu për rezultatet në drejtim të qasjes do të raportojnë agjencitë që janë sot prezentë, do të raportojnë SPAK-u, Prokurori i Përgjithshëm, si dhe agjencitë e tjera, por edhe qasja ndërgjegjësuere. Për i sa përket qasjes ndërgjegjësuere, dhe këtu dua të ndalem, falë një bashkëpunimi të shkëlqyer me ambasadën italiane, kemi finalizuar zbatimin e një projekti, modul antikorrupsioni, në katër shkollat e mesme të Tiranës në bashkëpunim edhe me organizatat italiane të luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, me qëllim edukimin që në rini me një qasje refuzuese ndaj korrupsionit. Duhet një hap i vogël, por shumë sinjifikativ, sepse korrupsioni dhe edukimi ligjor i qytetarëve shqiptarë për pasojat negative që sjell korrupsioni duhet të fillojnë që në programet e shkollimit, mundësisht ndoshta edhe në arsimin parashkollor.

Në lidhje me rekomandimet për adresimin me efikasitet të rekomandimeve të GRECO-s, nëse koha ka mbaruar, ndoshta, mund t'ju shpjegoj edhe nëpërmjet përgjigjeve që do të jepen, por më lejoni të them se nga 10 rekomandime, që ka bërë GRECO për Shqipërinë, 9 janë përmbushur, njëri është në proces për t'u përmbushur. Nëse doni të dini se cili është rekomandimi që nuk është përmbushur plotësisht dhe është në proces, ka të bëjë me plotësimin e Gjykatës së Lartë me numrin e nevojshëm të gjyqtarëve në këtë gjykatë. Në momentin kur Komisionin European ka bërë progresrapotin, ne kemi pasur vetëm 3 anëtarë në Gjykatën e Lartë, ndërsa sot që flasim në Gjykatën e Lartë ushtrojnë funksionet e tyre 13 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë dhe, nga bashkëpunimi dhe informacionet që kemi me Këshillin e Lartë Gjyqësor, deri në

fund të këtij viti Gjykata e Lartë në Republikën e Shqipërisë do të ketë numrin e nevojshëm të gjyqtarëve me 19 gjyqtarë, pastaj më në detaje jam i hapur për pyetje.

Jorida Tabaku – Faleminderit, zoti Manja, për prezantimin tuaj!

Unë para se t'ia jap fjalën Prokurorit të Përgjithshëm, zotit Çela, shkurtimisht do t'i kërkoja edhe atij një raportim të veprimtarisë së institucionit të tij, por dua të ngre 2-3 shqetësime. Besoj se demokracia është edhe *check & balance*, është edhe kontroll, demokracia dhe institucionet funksionojnë kur secili kryen punën e tij. Besoj se opozita ka shumë ankesa për zbatimin e reformës në drejtësi, për punën e institucioneve të pavarura, madje kemi edhe ekspertë shumë të mirë që mund të jenë edhe më të artikuluar. Shqetësimi im është kur pushteti sulmon këto institucione dhe unë nuk arrita dot të marr një përgjigje nga zoti Manja për sa i përket kësaj pike.

Së dyti, i kam dëgjuar me shqetësim deklaratat e Prokurorit të Përgjithshëm për sa i përket pastrimit të parave, sidomos në prokurorinë e Tiranës, pastrimi i parave është një element, i cili është shfaqur si kusht për Konferencën e Parë Ndërqeveritare, pasi Shqipëria u përfshi në listën gri të pastrimit të parave.

Unë do të kisha nevojë për më shumë informacion se çfarë po ndodh me këtë?

Së treti, krimet zgjedhore, e përmenda më parë, po e përmend edhe tani, për mua dosja e Dibrës, ku janë përfshirë disa ministra, ndër të cilët edhe i nderuari, zoti Manja, i ulur këtu ngjitur me mua, është shembulli më i keq se si nuk duhet një dosje hetimore të procedojë. 40 seanca pa asnjë dëgjuesë, disa ministra të përfshirë, çfarë po ndodh me dosjen e Dibrës? Hetimi i krimeve zgjedhore është një element shumë i rëndësishëm në procesin e integritetit.

Së fundi, në qoftë se mendojmë se Shqipëria ka vuajtur nga korrupsioni në digjitalizim, nuk kemi kuptuar asgjë. Unë shpresoj që këtë manualin, që ka përgatitur zoti Manja, të ka konsultojë me Kryeministrin dhe me ministrat për ligjvënien, se si duhet që ligjvënia të mos jetë korruptive.

Sot nga 9 ligje, të cilat cilësojnë kapjen e shtetit, 7 ligje i ka votuar zoti Manja. Sot kapja e shtetit me ligj, bërja e korrupsionit me ligj sot është fenomen që po kalon në parlament. Në qoftë se ky manuali do të na ndriçojë të gjithëve se si ju nuk do të votoni, për shembull, shtyrjen e afatit të ligjit të investimeve strategjike e me radhë, unë besoj se mund ta votojmë edhe ne të gjithë, si opozitë, në parlament, në qoftë se ka ngelur te ky element. Prandaj, kjo është një çështje edhe e vullnetit politik, zoti Manja, vullnetit politik për të mos e kapur dhe për të mos e

kontrolluar drejtësinë, për të mos e sulmuar drejtësinë dhe vullnetit politik për t'i çuar gjërat përpara.

Atëherë, për të përfunduar edhe me pyetjet për Prokurorin e Përgjithshëm, zoti Prokuror i Përgjithshëm, para zgjedhjeve të vitit të kaluar ju, njëkohësisht, përfunduat procedimin...

Ulsi Manja – A mund të jap një përgjigje?

Jorida Tabaku – Patjetër.

Ulsi Manja – Një përgjigje të shkurtër për pyetjet që bëtë?

Jorida Tabaku – Zoti Manja, ju lutem ta përfundoj logjikën, meqenëse e drejtoj unë këtë seancë.

Përpara se t'i jap fjalën zotit Prokurori të Përgjithshëm, vjet, përpara zgjedhjeve, përfundoi njëkohësisht edhe dosja hetimore për zotin Tom Doshi, që iu paraqit KQZ-së, unë besoj se është për anëtarët e nderuar të këtij komision që të kenë një informacion.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Një përgjigje të shkurtër, pastaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zonja kryetare, unë kam një përgjigje shumë të shkurtër për të gjitha ato që ju thatë, sepse ma përmendët emrin disa herë. Ju vazhdoni, dhe mirë bëni që i monitoroni seancat e dosjes nr. 184. Nga Dibra kam vetëm një merak që nuk të solla një tufë me lule më 8 Mars për ato 5080 vota që qytetarët e mi të Dibrës më nderuan në zgjedhjet e 6 marsit.

Kaq kisha.

Taulant Balla – Tani fjalën e ka Prokurori i Përgjithshëm, më pas drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

Olsian Çela – Faleminderit!

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Do të jem sa më koncizë në paraqitjen e të dhënave, për shkak të kufizimeve të kohës. Mund t'ju them se institucioni i prokurorisë, si pjesë e sistemit të drejtësisë penale, ka vijuar zbatimin e rekomandimeve, për të cilin jemi mbledhur sot. Në këtë kuadër, Prokurori i Përgjithshëm u ka rekomanduar prokurorëve të shkallëve të para dhe të apelit për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimet paraprake, si dhe kryerjen proaktive efektive me përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimit, në funksion të shtrimit të hetimeve, të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë, për rritjen e mëtejshme të efektivitetit në luftën kundër korrupsionit.

Prokurorët në vitin 2021 kanë rritur kryerjen e hetimeve proaktive me përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimit në 59 procedime penale për vepra penale të korrupsionit që lidhen me detyrën. Ky proces i ka shërbyer si parandalimit ose ndërprerjes së mëtejshme të veprimtarisë kriminale, ashtu edhe finalizimit me arrestimin në flagrancë apo ndalimin e 40 personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale në kompetencë të prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë me juridiksion të përgjithshëm. Në kuadër të zbatimit të aktit të koordinimit ndërinstitucional mes Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme, ka vijuar bashkërendimi i komunikimeve të drejtpërdrejta në nivel rrethi gjyqësor ndërmjet tyre. Në këtë vështrim, sipas të dhënave statistikore, prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm kanë transferuar 11 procedime apo referime penale në Prokurorinë e Posaçme.

Vetëm për vepra penale në fushën e korrupsionit në kompetencë lëndore të asaj prokurorie, disa raste nga të cilat, kryerja e hetimeve proaktive ka çuar në zbulimin e ekzistencës së veprimtarisë korruptive për kryerjen e hetimeve të mëtejshme nga kjo prokurori.

Referuar të dhënave statistikore për këto grupe veprash të korrupsionit në kompetencë të juridiksionit të përgjithshëm, janë regjistruar 100 procedime me 87 të pandehur dhe 54 procedime me 55 të pandehur janë dërguar për gjykim ose, krahasuar me një vit më parë, me një rritje tri herë të numrit të procedimeve të regjistruara dhe një rritje të numrit nga 3 në 54 procedime dhe nga 3 në 55 të pandehur të dërguar për gjykim, si dhe ka përfunduar gjykimi dhe janë dënuar 19 të pandehur për këto vepra penale.

Sipas tendencave për grupe veprash penale, për nenin 124/a të Kodit Penal “Kërkimi ose marrja e shpërblimit për proceduar e birësimit” është regjistruar vetëm një procedim në vitin 2020, ndërkohë që nuk ka të tilla në vitin 2021. Për nenin 164/b të korrupsionit pasiv në sektorin privat janë regjistruar 2 procedime, ndaj 1 të 1 viti më parë. Për nenin 244 të Kodit Penal “Korrupsioni aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike” janë regjistruar 66 procedime penale, ndaj 9 të tillave në vitin 2020.

Për nenin 245 “Korrupsioni aktiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë” janë regjistruar 2 procedime penale, ndaj 3 të tillave në vitin 2020.

Për veprën penale të ushtrimit të ndikimit të paligjshëm ndaj personave, që ushtrojnë funksione publike, janë regjistruar 2 procedime penale, ndaj 2 të tillave një vit më parë.

Për veprën penale të korrupsionit pasiv të personave me funksion publik janë regjistruar 15 procedime penale, ndaj 8 procedimeve në vitin 2020.

Për neni 328 “Korrupsion aktiv në zgjedhje” janë regjistruar 12 procedime penale me 8 të pandehur, ndërsa nuk është regjistruar ndonjë procedim i tillë në vitin 2020 edhe për shkak të situatës zgjedhore.

Për nenin 328/b të korrupsionit pasiv në zgjedhje është regjistruar 1 procedim me 2 të pandehur, ndërsa nuk regjistruar ndonjë procedim i tillë 1 vit më parë.

Referuar të dhënave statistikore, vërehet se për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal “Refuzimi për deklaram, mosdeklaram, fshehje ose deklaram i rremë i pasurive ose interesave private të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram”, ka tendencë në ulje të numrit të procedimeve dhe, konkretisht, nga 4 procedime të regjistruara në vitin 2020, ka 1 procedim të tillë në vitin 2021 ndaj një ish-gjyqtari lidhur me procesin e rivlerësimit kalimtar të tij.

Duke vlerësuar rëndësinë e aksesit në bazën e të dhënave për shpejtësinë, cilësinë dhe efektivitetin e hetimeve, kemi iniciuar nisma ligjore për aksesin në bazën e të dhënave shtetërore përmes marrëveshjeve dypalëshe me disa institucione dhe është nxjerrë edhe një udhëzim i përgjithshëm për ushtrimin e kësaj të drejte për hyrjen në bazën e të dhënave të të tretëve.

Ne kemi iniciuar nismën për disa shtesa dhe ndryshime ligjore, më qëllim që t’u lihet prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm hyrja në bazën e të dhënave shtetërore të çdo personi juridik privat, që ushtron funksion publik, dhe mbi këtë kërkesë Ministria e Drejtësisë ka përgatitur projektligjin “Për ndryshime dhe disa shtesa në ligjin nr. 97/2017 “Për prokurorinë”. Është miratuar me ligjin nr. 42/2021 një shtesë në nenin 108/a të këtij ligji për të drejtën e prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm që të kenë akses të drejtpërdrejtë, si subjekte të interesuara në sistemet e informacionit apo bazat e të dhënave të administruara nga institucionet shtetërore.

Nga ana jonë është kërkuar dhe jemi në pritje të përgjigjeve për marrjen e aksesit në bazën e të dhënave në regjistrin e pronarëve përfitues, në regjistrin qendror të llogarive bankare mbi bazën e të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, bazën e të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si dhe në bazën e të dhënave në sistemin elektronik të çështjeve të përmbartimit gjyqësor, si dhe bazën e të dhënave shtetërore të shërbimit të Regjistrimit Noterial Shqiptar, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, për të lehtësuar hyrjen dhe përdorimin e të dhënave në funksion të hetimit dhe

gjykimit të të dhënave penale të korrupsionit që lidhen me detyrën, si dhe pastrimit të parave, dhe jo vetëm, për sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale.

Gjithashtu, për rritjen profesionale të prokurorëve, nisur edhe nga rekomandimet, është vlerësuar si domosdoshmëri forcimi i kapaciteteve profesionale në luftën kundër korrupsionit. Në këtë kuadër, është bashkërenduar puna edhe me komisionin e Policisë Gjyqësore për forcimin e kapaciteteve profesionale të Policisë Gjyqësore të seksioneve, por edhe të prokurorëve dhe përmes ndihmës të disa prej misionëve që janë sot në Shqipëri për të asistuar drejtësinë, janë realizuar disa trajnime të tilla.

Gjithashtu, jemi angazhuar në veprimtarinë me objekt përmirësimin dhe funksionimin e sistemit statistikor, sistemit të analizës dhe digjitalizimit të komunikimeve. Në pamundësi të vënies në funksion të sistemit CAM, ka filluar puna për hartimin e një programi statistikor PRESTO për sistemin e prokurorisë me juridiksion të përgjithshëm. Po bëhen përpjekje për të vijuar punën e nisur, duke e ndarë procesin në disa faza.

Ndërkohë, me Ministrinë e Drejtësisë ka vijuar bashkëpunimi lidhur me procesin e raportimit periodik të të dhënave të harmonizuara të rekordi i historikut të hetimeve, i ndjekjeve penale dhe dënime të formës së prerë në luftën kundër korrupsionit për raportim në strukturat e BE-së dhe jo vetëm.

Për të shkuar te pjesa që lidhet me pastrimin e parave, krimit financiar dhe hetimet pasurore, theksoj se ky ka qenë sërish një objektiv prioritar institucional, në përmbushje të kërkesave dhe rekomandimeve.

Prokuroria e Përgjithshme, në mbështetje edhe të projektit të Euralius, në përmbushje të rezultatit imediat të planit të veprimit ICRG-FATF, përgatiti sistemin elektronik *e-tracking* PRESTO, me synim për të përfutur të dhëna statistikore gjithëpërfshirëse, të hollësishme dhe të besueshme, si dhe për të evidentuar arritjet dhe problematikat për eficiencën në ndjekjen penale të këtyre grup-veprave penale.

Rezultati i arritur në zbatimin e këtij sistemi është vlerësuar në vijimësi nga ekspertët e ICRG- FATF në raport-progresin për zbatimin e këtij plani veprimi.

Për sa u përket masave, ka një progres të evidentuar në rritjen e efektivitetit në hetimet për veprat penale të pastrimit të parave të parashikuara në nenet 287 dhe 287/b të Kodit Penal. Sipas të dhënave statistikore, në vitin 2021 është evidentuar se për veprat penale të parashikuara nga nenet 287 dhe 287/b të Kodit Penal janë regjistruar 301 procedime penale të reja me 56 të

pandehur, 18 procedime me 33 të pandehur, që janë dërguar për gjykim, si dhe 21 persona janë dënuar.

Këta tregues evidentojnë një rritje prej 7,01% të regjistrimeve të regjistruara dhe një rritje prej 31,25% të personave të dënuar për këto dy vepra të pastrimit të parave,

Megjithatë, për ta përmbyllur këtë raportim të shkurtër, unë vlerësoj se ka ende mjaft potenciale dhe kapacitete për ta përmirësuar punën tonë në luftën e pastrimit të parave. Siç edhe ju e përmendët, nuk është se ka një ritëm të njëjtë të punës në të gjitha prokuroritë e rretheve gjyqësore, kjo është parë nga ne me shqetësim, me të gjitha masat e marra në vazhdimësi që nga viti 2020 për t'u krijuar gjithë infrastrukturën e nevojshme prokurorive, qoftë në kapacitetet njerëzore, financiare, por edhe në drejtim të bashkëveprimit ndërinstitucional.

Relativisht ka përmirësime, ashtu siç duket, por hapësira për përmirësim është mjaft më e madhe se sa ajo që është arritur deri tani dhe mbetet goxha për t'u përmirësuar në këtë drejtim dhe do të jetë sërish një nga objektivat tanë për vitin në vijim.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Faleminderit, zoti Çela!

Ia jap fjalën zotit Kraja.

Zoti Kraja, në raportimin tuaj, që i keni sjellë këtij këshilli, ju përmendni njëkohësisht veprat penale të korrupsionit të zyrtarëve të lartë për periudhën fund 2021- fillim 2022, në mënyrë specifike përmendni hetimin ndaj zyrtarëve të lartë me statusin e ish-ministrit dhe deputetit të Kuvendit, të cilët hetohen për veprat penale, korrupsion, pastrim parash, njëkohësisht, edhe 3 ish-kryetarë bashkie. A vazhdojnë hetimet për dosjen e inceneratorëve? A ka të tjerë të hetuar me statusin deputet, apo jo? Unë ngrita disa shqetësime, që lidheshin me kapacitetet e SPAK-ut, në mënyrë të veçantë ngrita shqetësimin e sektorit të hetimit financiar, për të cilin SPAK-u ka hapur një thirrje në fund të prillit dhe me sa pashë, ka pothuajse 77 kërkesa për pozicionet e punës.

Besoj që, në shërbim të ngritjes së kapaciteteve, kjo do të ishte diçka shumë e mirë për krimet zgjedhore. Sa janë procedimet që ka SPAK-u në proces tani dhe a ka zyrtarë të lartë të përfshirë, apo jo? Ku ndodhet statusi i këtyre hetimeve, (pa specifikuar emrat, aq sa mund të lejojë edhe sekretin e hetimit)?

Njëkohësisht, duam të dimë edhe për sa u përket hetimeve proaktive. Ashtu siç thuhet në rekomandim, duhen marrë masa për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë.

Unë gjykoj se shifrat, që janë sjellë gjatë vitit 2021 nga ana e Prokurorisë së Posaçme kundër Krimit dhe Korrupsionit, janë filluar kryesisht 15 procedime penale, që janë rreth 5% të procedimeve penale të regjistruara këtë vit.

Faleminderit!

Arben Kraja – Faleminderit, zonja Tabaku!

Të nderuar deputetë,

Anëtarë të Këshillit Kombëtar të Integritetit,

Unë do të prezantoj shkurt arritjet e institucionit, në raport me rekomandimet e komisionit, pa diskutim, edhe në raport me atë çfarë ishte parashikuar në agjendë.

Do të kërkoja mirëkuptimin tuaj që, për arsye të kufizimeve ligjore, unë nuk do të jap asnjë përgjigje për çështje konkrete, gjithashtu, nuk do të jap asnjë opinion për institucionet e tjera, cilado qofshin ato. Kjo është e shkruar në ligj. E keni miratuar ju, kështu që unë thjesht do të respektoj ligjin që ju keni miratuar.

Ne jeni përfshirë në zbatimin e rekomandimeve, me aq sa është kompetenca e Prokurorisë së Posaçme dhe i jemi referuar gjithmonë zbatimit të rekomandimeve të Komisionit European për vitin 2021, si dhe nënkomitetit të BE-Shqipëri të vitit 2021.

Rekomandimet janë dhënë në tetor të vitit 2021, raport-progresi, pastaj në dhjetor ka qenë Komiteti BE-Shqipëri për Drejtësi dhe Liri, të cilët kanë përcaktuar rekomandimet, që lidhen edhe punën e prokurorisë në fushën kundër korrupsionit.

Prokuroria e Posaçme gjatë vitit 2021, si dhe në katërmujorin e parë të vitit 2022, në zbatim të detyrave dhe të funksioneve të saj kushtuese, ka qenë plotësisht e fokusuar në forcimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe hetimin e plotë e të gjithanshëm të veprave penale në fushën e korrupsionit, sidomos atyre në nivelet e larta.

Gjatë këtij viti, pra vitit 2021 dhe fillimi i vitit 2022 janë kryer dhe vazhdojnë të kryhen hetime të suksesshme, si dhe janë gjykuar dhe po gjykohen subjekte që kanë ushtruar funksione të larta shtetërore, ish-gjyqtarë, prokurorë, grupe të strukturuar kriminale me rrezikshmëri të lartë shoqërore e të tjerë.

Prokuroria e Posaçme, si institucion kontribuues dhe raportues, ka në fokus të saj zbatimin e rekomandimeve që lidhen me funksionin e institucionit. T'u referohemi më konkretisht rekomandimeve: të garantohet që Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar të adresojë në mënyrë efektive korrupsionin në nivelet e larta, të garantojë burimet e duhura dhe bashkëpunimin midis këtyre strukturave dhe organeve të prokurorisë. Ka qenë rekomandim i Komisionit, të njëjtën gjë ka thënë edhe nënkomisioni Shqipëri-BE në vijim.

Për të realizuar këto rekomandime, kemi vënë prioritet në punën tonë: jemi munduar të kryejmë sa më shumë hetime proaktive, të përdorim me efektivitetin maksimal burimet njerëzore që kemi pasur, prokurorë dhe hetues, kemi bashkëpunuar ngushtë me strukturat ligjzbatuese brenda vendit, në mënyrë të veçantë me Policinë e Shtetit dhe strukturat e inteligjencës, kemi bashkëpunuar ngushtë me institucionet homologe jashtë vendit. Treguesit statistikorë dhe cilësorë kanë ardhur gjithmonë në rritje të vazhdueshme. Koncepti i hetimit proaktiv nuk është thjesht fillimi i çështjeve kryesisht, por hetim proaktiv është një koncept pak më i gjerë, që do të thotë të hetosh pa e ditur të tjerët që po i heton dhe kur përdoren metoda speciale të hetimit. Mund t'ju garantoj që rreth 80% e rasteve, që kemi sot në dorë, janë në hetim proaktiv. Kemi qenë shumë të fokusuar në këtë fushë.

Po t'u referohemi shifrave, për katërmujorin e parë janë në hetim 232 procedime penale me 131 persona për veprat penale të korrupsionit, si dhe veprat penale, të parashikuara nga nenet 257 dhe 328, që do të thotë deklaram i rremë i funksionarëve dhe i korrupsionit në fushën zgjedhjeve.

Në mënyrë të detajuar unë i kam dhënë shifrat, pasi materiali u është dhënë të gjithë deputetëve, prandaj nuk do të futem në detaje. Po kështu, në të njëjtën periudhë janë dërguar për gjykim 11 procedime penale me 36 të pandehur për të njëjtat vepra penale. Të dhënat e mësipërme janë tregues se Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit janë të përkushtuara në hetimin e plotë dhe efektiv të çdo rasti që përmban elemente të veprave penale që lidhen me korrupsionin, për të cilin kjo strukturë merr dizeni, sipas formave të parashikuara në ligj.

Në lidhje me veprat penale të korrupsionit të zyrtarëve të lartë për periudhën fundi i vitit 2021 dhe fillimi i vitit 2022, në mënyrë specifike përmendim hetimet ndaj disa zyrtarëve të lartë me statusin e ish-ministrit dhe të deputetit të Kuvendit, të cilët hetohen për vepra penale që lidhen me korrupsionin dhe pastrimin e parave. Ndërkohë, në gjykim janë 3 ish- kryetarë

bashkie, të cilët, sipas ligjit, përfshihen në kategorinë e zyrtarëve të lartë. Duhet të na mirëkuptoni për këtë, sepse jemi në një fushë, si të thuash, të ngatërruar, nga njëra anë, thuhet se nuk mund të raportohet për çështje konkrete, nga ana tjetër, duhet të japësh të dhëna për të treguar se ke një tendencë apo prioritet në këto çështje që lidhen me zyrtarët e lartë. Kjo që kam paraqitur, duhet të na kuptoni është në këtë mënyrë.

Një rekomandim tjetër ka qenë: të garantohet se procedimet penale iniciohen në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të akuzuar për sjellje kriminale gjatë procesit të rivlerësimit. Ky ishte një rekomandim i vazhdueshëm që është dhënë nga institucionet e BE-së.

Bazuar në parashikimet e nenit 75/a, gjerat “s” dhe “ç”, të Kodit të Procedurës Penale, subjektet, ndaj të cilave mund të fillohen hetime nga Prokuroria e Posaçme, dhe që lidhen me këtë rekomandim, janë vetëm ish-gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, si dhe ish-Prokurori i Përgjithshëm. Përmendim këtu kompetencën për shkak të subjektit, pasi organet e rivlerësimit kalimtar me vendimet e tyre për subjektet e shkarkuara nga detyra nuk kanë paraqitur deri tani ndonjë kallëzim penal kundër gjyqtarëve apo prokurorëve të shkarkuar apo të dorëhequr për ekzistencën e veprave penale të parashikuara në kompetencat e hetimit të Prokurorisë së Posaçme. Po kështu, as institucioni i Kontrollit të Deklarimit të Pasurive nuk ka paraqitur ndonjë kallëzim penal në Prokurorinë e Posaçme ndaj këtyre subjekteve.

Nga SPAK-u janë regjistruar procedime penale, janë kryer hetime ndaj disa subjekteve me cilësinë e gjyqtarit apo prokurorit. Hetimet janë regjistruar mbi bazën e kallëzimit dhe kryesisht nga vetë prokurorët.

Në këtë periudhë janë dënuar nga Gjykata e Shkallës së Parë për korrupsion 1 gjyqtar dhe 2 prokurorë, procedime të nisura kryesisht nga ana jonë, janë në hetim 3 ish-gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, ndërkohë që janë në gjykim 2 ish- gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese.

Përveç hetimeve penale kundër subjekteve dhe rrethit të tyre familjar, kemi kryer edhe hetime pasurore, sipas parashikimeve të ligjit nr. 10 192 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ose, siç quhet ndryshe, ligji antimafia.

Në këtë kuadër, janë sekuestruar një numër i lartë dhe me vlerë të konsiderueshme pronash të paluajtshme në pronësi të ish- gjyqtarëve dhe prokurorëve, për të cilët kemi procese penale apo familjarëve të tyre, të cilët nuk justifikohen me burime të ligjshme. Po vazhdojmë me

kryerjen e veprimeve dhe proceset gjyqësore për të realizuar konfiskimin e këtyre pasurive dhe kalimin në favor të publikut.

Një rekomandim tjetër ka qenë: të vijohet me fuqizimin e luftës kundër korrupsionit, të bëhet më shumë progres në krijimin e një historiku hetimesh, ndjekjesh penale dhe gjykimit të çështjeve të korrupsionit, sekuestrimin dhe konfiskimin e asetëve, që vijnë nga vepra që lidhen me korrupsionin. Të njëjtin rekomandim ka dhënë edhe nënkomiteti. Për të gjitha rastet e hetimeve për korrupsion apo abuzim me detyrën e zyrtarëve të lartë apo të funksionarëve të drejtësisë është bërë edhe hetimi pasuror nga SPAK-u, pa diskutim edhe evidentimi i pasurive të tyre dhe në rastet, kur nuk kanë qenë të justifikuar, është kërkuar sekuestro në gjykatë. Kemi qenë të përfshirë në të gjitha grupet e punës, që janë ngritur nga Ministria e Drejtësisë, që ka institucionin që raporton kryesisht, për efekt të raportimit të statistikave, harmonizimit me njëri-tjetrin dhe krijimit të *track rekord*, të ndjekjes së rasteve nga fillimi deri në fund, kuptohet duke dhënë kontributin tonë, për aq sa kemi kompetenca.

Një rekomandim tjetër ka qenë që Shqipëria duhet t'i trajtojë në mënyrë efektive rekomandimet e GRECO-s dhe të zbatojë planin e veprimit brenda kornizës; ka qenë një rekomandim kryesor i Komisionit European. Në lidhje me këtë, konkretisht: të përfundojë rekrutimi i stafit të prokurorisë, i stafit teknik të Prokurorisë së Posaçme dhe anëtarëve të tij t'u ofrohen burime të përshtatshme njerëzore dhe prokurorët të marrin trajnim dhe specializim të lartë.

Gjatë vitit 2021 Këshilli i Lartë i Prokurorisë me vendimet nr. 243 dhe nr. 244 të korrikut, si dhe nr. 387 dhe nr. 388 të 13 dhjetorit ka emëruar 4 prokurorë të rin. Aktualisht, duke filluar nga data 1 janar e këtij viti në Prokurorinë e Posaçme ushtrojnë funksionet 17 prokurorë, të cilët kryejnë veprimet e tyre, bazuar në kompetencat që kanë, nga 20 numri që është miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin nr.6/2021.

Për sa i përket Byrosë Kombëtare të Hetimit, është parashikuar që numri tërësor i hetuesve do të jetë 60. Në muajin shtator të vitit 2021 filluan detyrën 28 hetuesit e parë të BKH-së, vetëm 6 muaj përpara. Ndërkohë që gjatë gjysmës së dytë të vitit 2021 u zhvilluan procedurat për përzgjedhjen e grupit të dytë të hetuesve, të përbërë nga 32 të tjerë. Në përfundim të përzgjedhjes, pasi u bë vetingu i kandidatëve të kualifikuar, u arrit që në muajin mars 2022 të fillojë faza e trajnimit të grupit të dytë të hetuesve, e cila zgjat 16 javë. Nga gjysma, ose fundi i muajit qershor do të jenë aktivë për të filluar detyrën. Trajnimi po kryhet nga ekspertët më të

mirë shqiptarë në bashkëpunim me FBI-në dhe DIA-n italiane. Një komision ndërkombëtar, i përbërë nga 2 ekspertë të qeverisë së SHBA-ve, si dhe 2 ekspertë të BE-së, bazuar në kompetencat dhe ligjin e SPAK-ut, kanë ndjekur dhe ka kanë dhënë rekomandime të vazhdueshme gjatë gjithë procesit të rekrutimit të hetuesve të BKH-së, si dhe gjatë procesit të përgatitjes së kurrikulave të trajnimit apo rregulloreve të brendshme të tyre.

Ligji organik i SPAK-ut parashikon edhe krijimin e një sektori hetimor financiar në Prokurorinë e Posaçme të përbërë nga oficerë të Policisë Gjyqësore, me eksperiencë në hetimin pasuror dhe financiar. Është parashikuar një strukturë prej 8 hetuesish dhe është hapur konkurrimi në fund të muajit prill të vitit 2022. Deri tani kanë konkurruar 71 kandidatë për 8 vende dhe komisioni i përzgjedhjes, i përbërë nga 3 prokurorë të posaçëm, është duke kryer verifikimet përkatëse të kriterëve formale dhe ligjore. Procedura do të vazhdojë sipas rregullores së miratuar dhe të bërë publike në faqen zyrtare të SPAK-ut.

Për këtë moment dua të them, sepse, me të drejtë, mund të dalë pyetja pse ka filluar kaq vonë kjo procedurë dhe është hapur konkurrimi për një sektor kaq të rëndësishëm, se duhet të kemi parasysh që në momentin e parë, kur kemi bërë gati për të filluar procedurën, kemi konstatuar problematika të ligjit, i cili, e para nuk përcaktonte se çfarë statusi do të kishin këta, do të ishin oficerë të Policisë Gjyqësore apo jo, do ta kishin apo jo statusin; e dyta, nuk ishte përcaktuar paga e tyre. Në këto kushte, kemi komunikuar me Komisionin e Ligjeve dhe u arrit në korrik të vitit të kaluar që të realizohej procedura dhe të saktësohej ligji për këtë gjë. Kjo na dha mundësinë për të hapur garën. Duhet të kemi parasysh edhe diçka tjetër: ligji i SPAK-ut, nisur nga ideja e mirë për t'i dhënë pavarësi në ngritjen e strukturës dhe në marrjen e stafit në punë, parashikon që çdo procedurë do të bëhet po nga SPAK-u, që do të thotë se prokurorët, përveçse do të shkojnë në 3 shkallët e gjyqimit për të mbrojtur çështjet e tyre, duhet të bëjnë vetingun, duhet të bëjnë përzgjedhjen e hetuesve të Byrosë, përzgjedhjen e hetuesve financiarë e të tjera. Të gjithë këto me 10-12 prokurorë që kemi qenë apo 15 që kanë qenë gjatë vitit të kalua kuptohet që na krijon mbingarkesa.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, mbarova, nëse mundem, apo mund ta ndërpres?

Trajnimet kanë qenë të vazhdueshme si për hetuesit, edhe për prokurorët. Përmirësimi i metodologjisë së mbledhjes së të dhënave ka qenë një rekomandim tjetër, për të krijuar një sistem të unifikuar të menaxhimit të çështjeve për ndjekjen penale dhe dënimet. Prokuroria e

Posaçme nuk ka qenë dhe nuk është e përfshirë në sistemin e menaxhimit të çështjeve, që po bëhet nga Prokuroria e Përgjithshme. Jemi duke punuar për të krijuar sistemin tonë të menaxhimit. Si fillim, kemi ngritur rrjetet përkatëse të sigurisë brenda institucionit, i kemi certifikuar të gjitha sipas standardeve të DSIK-së, kemi vendosur lidhje me fibër optike të SPAK-ut me Prokurorinë e Përgjithshme, me Drejtorinë e Policisë së Shtetit, me AKSHI-n dhe kemi siguruar një akses të lartë të sistemeve dhe bazave të të dhënave në dispozicion të prokurorëve dhe të hetuesve të BKH-së për efekt të hetimit të çështjeve penale.

Të nderuar deputetë, Prokuroria e Posaçme i ka vlerësuar maksimalisht rekomandimet e dhëna nga Komisioni Europian për Shqipërinë, që lidhen me kompetencat e SPAK-ut, i kemi vënë si prioritet, kemi ndërtuar punën për t'i realizuar në kohë dhe sipas standardeve të duhura. Kemi raportuar në mënyrë periodike, sa herë janë kërkuar informacione apo raportime konkrete, duke e bërë këtë nëpërmjet institucioneve shqiptare që drejtojnë procesin e negociimit duke filluar nga kryenegociatori, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme e të tjerë por edhe drejtpërdrejtë në kontakte me institucionet evropiane ose përfaqësuesit e tyre në Shqipëri.

Kemi qenë aktiv dhe me pjesëmarrje cilësore me përfaqësuesit tanë në të gjitha takimet e zhvilluara ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së. Me të njëjtin seriozitet dhe përgjegjshmëri ju garantoj se do të vazhdojmë edhe në të ardhmen.

Do të kërkoja edhe diçka tjetër që të jetë në vëmendjen tuaj, që kur të diskutohet për efektivitetin ose rezultatin e një strukture, mendoj se duhet të jemi në baza të njëjta krahasimi. Do të thotë se e para duhet të kemi të qartë se Struktura e Posaçme ende nuk është strukturë e posaçme, siç ju e keni parashikuar në ligj. Kjo do të thotë se grupi i parë i hetuesve ka filluar vetëm 5 muaj përpara, grupi i dytë ende nuk ka filluar. Prokurorët nuk janë të gjithë, stafi administrativ është pothuajse i plotësuar, por ka problematikat e veta, së pari.

Së dyti, Prokuroria e Posaçme ka dy vjet e gjysmë aktivitet dhe të krahasosh një strukturë që ka dy vjet e gjysmë aktivitet me strukturat e tjera, që kanë 20 vjet aktivitet, besoj se nuk është e drejtë. Ajo që mendoj dhe që ne japim dhe garantojmë është vullneti për të ecur në këtë rrugë që kemi filluar, pa diskutim duke vlerësuar eksperiencat më të mira botërore, por edhe duke bashkëpunuar ngushtë me të gjitha strukturat brenda vendit, por edhe me ato jashtë.

Faleminderit!

Jorida Tabaku - Faleminderit, zoti Kraja!

Është e vërtetë që ligji parashikon ngritjen e Strukturës së Posaçme që përfshin prokurorinë, Byronë dhe gjykatën dhe raportimi i institucioneve ka qenë, në fakt, edhe për këtë pjesë, duke falënderuar tre prezantuesit dua t'ia jap fjalën kolegëve për pyetje.

Ju lutem, nuk do t'ia ndërpres fjalën kolegëve deri në tri minuta, pas tri minutash fjala do të ndërpritet dhe do të jemi në kontekstin e pyetjeve.

Fjalën e ka kërkuar zoti Alibeaj, zonja Bushka. Do të respektoj radhën një nga opozita një nga qeveria. Paska shumë interes sot nga qeveria për pyetje, kështu që besoj se do të jemi këtu gjatë.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Më falni, pra, një nga maxhoranca një nga opozita.

Enkelejd Alibeaj – Falemidnerit!

Zonja kryetare, do të mundohem që brenda 3 minutëshit tim të bëj edhe parashtresën edhe pyetjet, por nuk mund të rri pa folur për atë se çfarë është një simptomë, në fakt, që u shfaq edhe këtu dhe që është paternalizmi politik, sidomos kur jemi përpara përfaqësuesve të drejtësisë. Reforma në drejtësi një nga qëllimet që ka është pikërisht kjo gjë, që çdo kush nga politika të autofrenojë më së paku për të mos krijuar as në aparençë në sytë e publikut ndërhyrjen. Gjë që nuk është se i ka shpëtuar madje edhe sot. Reforma në drejtësi këtë kishte si pikësynim. Progres raporti i këtij viti ka theksuar se gjykatat janë të mbingarkuara dhe ka vakanca të shumta në sistem dhe ky është një problem. Paralizimi i sistemit gjyqësor është një nga problemet. Procesi i vetingut ka krijuar vakanca në gjykatat e zakonshme, si edhe në Gjykatën Lartë dhe Gjykatën Kushtetuese dhe vazhdojnë ende edhe pse Gjykata Kushtetuese, në një farë mënyrë, ka filluar të jetë funksionale, por se simptoma është ende. Dhe kjo ndodh për shkak se Gjykata e Lartë ende nuk është funksionale.

Tjetër çështje që dua të ngre janë dy standardet e procesit të vetingut dhe kohëzgjatja e vetingut. Pra, një gjë e thënë prej shumë e shumë kohësh. Ka magjistratë që për të njëjtin shkak janë larguar dhe disa të tjerë nuk janë larguar. Nga ana tjetër në KPA, të paktë dy anëtarë janë larguar dhe kjo prek integritetin moral të mekanizmit të vetingut.

Së treti, ndërhyrjet politike në gjyqësor, është një nga çështjet primare dhe kardinalë. Është e patolerueshme që në progres raport të thuhet se mbetet ende shqetësim ndërhyrja politike. Është i papranueshëm fakti, që Kryeministri i këtij vendi, që nuk është as anëtar i Këshillit të Integritetit, të kërkojë llogari brenda suazës parlamentare, të mund të kërkojë llogari

dhe të hedhë shigjeta akuzash. Në fakt, e gjithë politika duhet të kuptojë një gjë që sukcesi i sistemit të drejtësisë dhe i reformës është besimi i publikut te drejtësia. Çdo ndërhyrje e rrënon këtë besim. Çdo ndërhyrje politike krijon situata të papërshtatshme. Nëse drejtësia do të ecte sipas kërkesave politike të Kryeministrit gjëja e parë do të ishte në aparençë, drejtësia është nën kontrollin e Kryeministrit, dhe tjetra, nëse nuk do të vepronte, do të konsiderohej përsëri e tillë.

Këto janë çështje për të cilat do të doja një përgjigje nga zotërinjtë që janë pjesëmarrës.

Ju lutem, edhe 30 sekonda për një çështje tjetër, që ka të bëjë me publikun dhe që është harta e re gjyqësore, e cila prek drejtpërdrejtë njerëzit. Çfarë ndodh dhe pse po ndodh që një hartë e re gjyqësore po krijohet ndërkohë që njerëzit janë në errësirë të plotë? Kam përshtypjen se tregon disfunkcionin thelbësor të sistemit të drejtësisë.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Faleminderit!

Zonja Bushka.

Edhe zonja Bushka 30 sekonda më shumë për barazi.

Klotilda Bushka – Unë e vlerësoj shumë të rëndësishme këtë dëgjese në kuadër të procesit të integritetit evropian sa i takon detyrimeve në këtë sektor. Kjo nuk është e rëndësishme vetëm për përmbushjen e detyrimeve, që na çojnë më pranë familjes europiane, por ka rëndësinë e vet sepse përballë publikut ne kemi marrë përsipër përgjegjësinë e arritjes së rezultateve nëpërmjet një reforme gjithëpërfshirëse në drejtësi dhe përgjegjshmëria jonë është njësoj përballë të gjithë qytetarëve.

Më duhet të pranoj që prandaj qasja jonë është një kërkesë më e shtuar ndaj rezultateve për t'iu përgjigjur pritshmërive të publikut, për të çrënjësuar kulturën e pandëshkueshmërisë dhe për të garantuar barazi para ligjit të qytetarëve. Nisur nga kjo parathënie kam tri pyetje për të dy përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme duke iu referuar kushteve të vëna në progres raportin e vitit 2021, lidhen me rekomandimin 1 dhe 3, pikërisht me atë që thashë çrënjësuesin e pandëshkueshmërisë. Një nga kërkesat është të kemi hetime për zyrtarët e lartë në mënyrë që rezultat të shihen dhe të tregohet që kjo luftë po bëhet dhe është efektive. Pra kërkohet jo vetëm të bëhet, por edhe të tregohen këto rezultate.

A duhet të besojnë sot shqiptarët se po respektohet barazia e shtetasve para ligjit në këtë sektor? Cila është qasja e institucioneve në këtë drejtim? A keni ju konkretisht udhëzime ose akte që normojnë rendin e ndjekjes së çështjeve në hetim? A ka plan pune? A i kushtoni ju

rëndësi në vendosjen e prioriteteve, afateve të parashkrimit të veprës penale? Pra, a keni një rend prioritetesh?

Çështja tjetër ka të bëjë me kompetencat e dy prokurorive. Nëse i referohemi nenit 135 të Kushtetutës ka një rreth subjektësh që janë në Prokurorinë e Posaçme, të cilat mund të hetohen. I njëjti rreth përcaktohet edhe në Kodin e Procedurës Penale. Duket se kompetenca për magjistratët, dhe e lidh këtu me kushtet e progres raportit, ndahet mes SPAK-ut dhe prokurorisë së zakonshme. A keni ju bashkëveprim për të unifikuar si dy institucione standardet e hetimit, duke qenë se bëhet fjalë për të njëjtin rast të veprës penale? Pra, bëhet fjalë për verat penale të korrupsionit, por me dy kompetenca dhe juridiksione të ndryshme.

Kemi bërë disa ndryshime ligjore në Kodin Penal në vitin 2020, të cilat ulën ngarkesën e Prokurorisë së Posaçme, duke hequr atë që ne i quajmë krime të vogla korrupsioni. A ju kanë ndihmuar këto që në ngarkesën e punës së përditshme të keni me shumë efektivitet, pra të fokusoheni më shumë te çështjet e thelbit? A mendoni se në këtë kuadër ka nevojë për ndryshime të tjera ligjore në mënyrë që të përmbushni edhe pritshëmrinë e publikut por edhe detyrimet për integrimin në BE? Çfarë mund të bëjë Kuvendi më shumë për të ndihmuar punën e institucioneve tuaja që të përmbushni detyrimet e vendosura nga BE-ja?

Jorida Tabaku - Faleminderit!

Ka një sugjerim nga kolegët që të marrim pyetjet për institucionet e pavarura dhe më pas mund të caktojmë edhe një datë tjetër për raportimin. Ka disa pyetje që lidhen me KLP-në dhe KLGJ-në, për të cilat ndoshta duhet të kishim thirrur këtu përfaqësuesit e tyre. E kemi mundësinë. Kështu që unë ftoj kolegët të bëjnë një grup pyetjesh.

Fjalën e ka zonja Çupi, pastaj zonja Gjylameti dhe pastaj zonja Gjonaj.

Taulant Balla - Unë kam diçka për procedurë.

Stafi i Këshillit Kombëtar të Integritimit duhet të bëjë zbardhjen e të gjitha pyetjeve, sepse unë i kam numëruar deri tani janë 17 pyetje, kështu që të gjitha këto duhet të merren dhe të jenë gati për zotërinjtë që janë këtu.

Bie dakord me propozimin që të marrin pyetjet dhe të caktojmë një datë tjetër për përgjigjet, që të jemi serioz në përgjigjet e pyetjeve.

Jorida Tabaku – Faleminderit!

Blerina Gjylameti - Faleminderit ministrit për raportimin, po ashtu edhe dy drejtuesit e institucioneve të drejtësisë në mënyrë të veçantë, jo vetëm për raportimin, por për punën e bërë

ndër vite dhe rolin proaktiv që keni luajtur në një prej plagëve më të mëdha të shoqërisë shqiptare të këtyre 30 vjetëve tranzicion, që është korrupsioni.

Ndërkohë, nga ana tjetër, kam disa pyetje, të cilat do të doja t'ju drejtoja në mënyrë të veçantë për të kuptuar më shumë dhe për të qenë më të qartë në atë se cili është roli juaj kryesor. Këtë e kam për të dy drejtuesit, ministrin kemi pasur mundësi ta kemi edhe në seanca të tjera dhe t'i drejtojmë pyetje, të Prokurorisë së Posaçme dhe të Prokurorisë së Përgjithshme.

Pyetja e parë ka të bëjë me luftën kundër korrupsionit dhe vendosjen e prioriteteve. Gjithmonë dëgjojmë që jeni të angazhuar në këtë luftë dhe po ashtu jeni të angazhuar edhe në hetime të rasteve të veçanta të niveleve të larta, por unë do të doja të dija në lidhje me prioritetet tuaja.

Dëgjova në fund të fjalës së zotit Kraja që nuk do të duhej të krahasoheshim me institucione që kanë 20 vjet që funksionojnë në shtetin shqiptar apo më shumë, me institucione që janë rishtarë dhe që kanë dalë si pasojë e një prej reformave më të rëndësishme në Republikën e Shqipërisë, që është reforma në drejtësi. Dëgjova që keni edhe problematika në lidhje me stafin dhe po ashtu me funksionimin e tij për sa kohë që nuk është plotësuar organika.

Pyetjen e kam për të dy drejtuesit.

Së pari, zoti Çela, në lidhje me prioritetet, a keni vendosur një listë prioritetesh në punën tuaj të përditshme? Në anën tjetër zoti Kraja, duke qenë se keni një numër të kufizuar dhe jo të plotësuar të organikës, a keni vendosur në planin tuaj të punës një prioritet ose një listë prioritetesh të çështjeve që duhen ndjekur, duke qenë se jeni edhe të kufizuar me prokurorët që keni dhe ende nuk është arritur numri i tyre?

Nga ana tjetër, do të doja të dija diçka në lidhje me çështjet ndër vite. Siç jua thashë, kjo është një ndër plagët më të mëdha të shoqërisë shqiptare dhe ajo që të gjithë presin dhe duan të dëgjojnë se çfarë po ndodh janë çështjet e vendosura ndër vite, të cilat nuk kanë marrë kurrë përgjigje nga drejtësia shqiptare. A po i hetoni? Mund t'ju duket si pyetje e përsëritur, por unë besoj se si përfaqësuese e një numri të madh qytetarësh në Kuvendin e Shqipërisë do të doja dija se çfarë po ndodh me 21 Janarin? A është hetuar 21 Janari siç duhet dhe a duhet të hetohet?

Do të doja të dija se çfarë po ndodh me çështjet e korrupsionit, sikundër është CEZ-i dhe privatizimi i tij? Do të doja të dija përsëri çfarë po ndodh me çështje të tjera që kanë pasur korrupsion ndër vite të institucioneve shqiptare, duke e mbështetur, siç e thashë pak më parë, punën tuaj në lidhje me çfarë po ndodh edhe sot? Nga ana tjetër, do të dija sa i takon sistemit të

drejtësisë, vazhdoj ta përsëris këtë, nëse ne ndërmorëm një reformë kaq të rëndësishme e ndërmorëm pikërisht sepse sistemi i drejtësisë shqiptare ishte një sistem i kalbur në gjenezë. Çfarë po ndodh?

Dëgjova në fjalën tuaj që neni 75, më pas edhe në raportin që na keni sjellë, e kufizon fushën tuaj të veprimit në nivelet e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, por ndërkohë nuk kufizon veprimin tuaj, të dy drejtuesve të institucioneve, sa u përket të gjitha niveleve, sepse mund ta nisni edhe këtë çështje kryesisht.

Unë mendoj që ju do të duhet të keni një rol proaktiv me çka po ndodh në Shqipëri edhe në këtë kohë të kufizuar që kemi, sepse duke u nisur të merremi me kokën e korrupsionit mund të arrijmë edhe në ato çfarë ndodh pak më poshtë, por duhet të nisim t'i japim përgjigje pikërisht asaj që ka ndodhur gjatë 30 vjetëve.

Më tej, do të doja të dëgjoja nga ju në lidhje me problematikat që keni. Çfarë prisni si mbështetje nga Kuvendi i Shqipërisë? Ju keni ardhur për të raportuar në Komisionin e Ligjeve, këtu jemi në Këshillin Kombëtar të Integritit, çfarë prisni si mbështetje nga Kuvendi i Shqipërisë në mënyrë të posaçme për të ndryshuar dhe për t'ju mbështetur në këtë luftë kundër korrupsionit që është edhe busulla jonë për të vijuar më tutje me atë që është rrugëtimi ynë drejt Bashkimi Europian?

Ju falënderoj shumë!

Do të doja që kur të marrim përgjigjet të kemi edhe kërkesat tuaja konkrete për mbështetjen që kërkon nga ne.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Çupi.

Dhurata Çupi – Faleminderit, zonja kryetare!

Së pari, dua t'ju sqaroj që në këtë komision mblidhemi në mbledhje periodike për të mirën e vendit dhe më tej të marrim masa për të plotësuar kushtet që na kërkon anëtarësimi në Bashkimi Europian. Pra, ne këtu mblidhemi për çështjet në të mirë të shqiptarëve, të cilat duhen diskutuar hapur. Këtu, në fakt janë 3 pushtetet, pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, që pretendohet të jenë të pavarur nga njëri-tjetri. Refuzoj të trajtohen institucionet e pavarura që thirren këtu, sikur i kemi thirrur në provim. Ne këtu diskutojmë, nuk u kërkojmë llogari, por ne

diskutojmë për të mirën e vendit, për të mirën tonë të brendshme dhe për atë që na shërben për të plotësuar kushtet e vendosura nga partnerët tanë.

E kam parë gjatë gjithë këtyre javëve që institucionet e pavarura thirren në monitorim ose në raporte dhe ne ju vendosim qytën përpara, çfarë keni bërë dhe u kërkojmë llogari sikur këtu do të marrin provimin e jetës. Ne jemi institucione të pavarura në atë që konsiderohet 3 pushtetet *check and balance*, pra ne sigurisht monitorojmë njëri-tjetrin, por edhe duhet të balancohet ajo çka ne u kërkojmë institucioneve. Ne nuk mund të pretendojmë që këtu ligjvënësi u kërkon llogari institucioneve të pavarura se ne qenkemi më të përgjegjshëm se këta që, kryesisht, votohen nga ligjvënësi.

Pyetja e parë është për eficiencën e institucioneve. Çfarë ndihme kërkojnë SPAK-u dhe Prokuroria e Përgjithshme nga ligjvënësi sa i takon ligjbërjes? Si mund t'i ndihmojmë ne për të qenë më eficientë për atë që paketa ligjore nuk i ka mundësuar deri më sot dhe që i pengon në punën e tyre? Kam konstatuar që ka mbivendosje kompetencash të disa autoriteteve vendimmarrëse lidhur me institucionet e tjera. Pra, cila është ndihma që u duhet nga ligjvënësi këtyre institucioneve sa i takon ligjbërjes?

Nga ana tjetër, këto institucione, mundësisht, të na japin informacione në perceptimin për qytetarët gjithmonë, jo për veten tonë, për nivelin e korrupsionit. A ka korrupsion në këtë vend dhe sa është niveli? A ka pastrim parash në këtë vend dhe sa është niveli? Sepse vetëm për vitin 2021 janë 15 raporte të institucioneve ndërkombëtare vetëm për korrupsionin. A ka pastrim parash? E theksoj. A ka korrupsion? E theksoj. A ka pabarazi në tendera?

Jo më vonë se para 1 jave deputetët e opozitës kanë raportuar në Komisionin e Ligjeve që 1 në 3 tendera merret pa garë, që 1 nga 3 tendera merret me fondin limit të përcaktuar, që 1 në 3 tendera merret në 99 dhe 100% të fondit limit.

Taulant Balla – Mbaroi.

Dhurata Çupi – Pyetja e fundit: a ka nga ana e institucioneve të pavarura në hetim sa i takon lobimit që bëhet për miratimin e ligjeve të veçanta?

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Faleminderit, zonja Çupi!

Besoj se i shihni kolegët socialistë që, sa herë prek atje ku nuk duhet, hidhen të gjithë në kor.

Fjalën e kanë kërkuar zonja Gjonaj, zoti Naço, zonja Kodheli dhe zoti Koçi.

Etilda Gjonaj – Faleminderit për prezantimin 3 përfaqësuesve të institucioneve, të cilët kanë ardhur këtu dhe ndërkohë po dëgjojnë edhe pyetjet tona në mënyrë të duruar, por unë besoj që ky proces ka rëndësi për sa kohë bëhet fjalë për rekomandimet e progresraportit të Bashkimit European, duke ditur që reforma në drejtësi është një ndër kushtet kryesore për sa i përket zbatimit të saj lidhur me procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin European.

Pa dashur të zgjatem shumë lidhur me komentet apo me çfarë është bërë me pjesën e politikave në aspektin e luftës kundër korrupsionit nga qeveria, ashtu edhe për reformën në drejtësi, për mbështetjen politike, për mbështetjen financiare që është dhënë apo edhe mbështetjen me kuadrin legjislativ, të ndryshuar edhe mbi bazën e nevojave që ka diktuar koha, do të ndalesha te 3 pyetje kryesore.

E para, lidhur me hetimet e nisura, kryesisht, pavarësisht se ashtu siç edhe zoti Kraja e përmendi, hetimet proaktive janë të një niveli më të gjerë, jo vetëm thjesht ato që nisen kryesisht. Edhe nga rekomandimet e Këshillit të Ministrave të 2021-t është kërkuar një rol proaktiv i prokurorëve në të dy prokuroritë si në juridiksion të përgjithshëm, edhe të posaçëm sa u përket hetimeve paraprake, por nga ana tjetër ka një nevojë për të rritur hetimet kryesisht.

Ajo që rezulton nga raportet, si raporti i Prokurorisë së Posaçme dhe i Prokurorisë së Përgjithshme, te Prokuroria e Posaçme ka të njëjtin numër në krahasim me 2020-n për ato çështje që janë nisur, kryesisht, ndërsa në Prokurorinë e Përgjithshme ka një dyfishim të numrit, por përsëri lë për të dëshiruar pjesa e hetimeve proaktive. Në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të progresportit, në kuadër të zbatimit të rekomandimeve të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit do të doja të dija se cilat janë masat që janë marrë nga të dyja institucionet për të rritur numrin e hetimeve proaktive, duke mbajtur në konsideratë pa dyshim të gjitha problematikat që vijnë edhe me mosplotësimin e strukturës së plotë të SPAK-ut, Prokurorisë së Posaçme, me të gjithë prokurorët, ashtu si edhe me hetuesit, të cilët, në fakt (prokurorët e Prokurorisë së Posaçme) do të duhet të ishin emëruar me kohë për sa kohë që struktura me 20 prokurorë është miratuar që në janar të vitit 2021 nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Pyetja e dytë lidhet me pjesën e raporteve ndërkombëtare, por njëkohësisht edhe rekomandimet e qeverisë. Po u referohem përsëri atyre të vitit 2021, ku theksohet në mënyrë të përsëritur nevoja e adresimit të prioriteteve në politikën penale, duke e kërkuar fokusimin në çështjet e interesit publik. Pyetja është për të dy drejtuesit: si e shikoni dhe si e gjeni ju veten në raport me këto rekomandime, duke e konsideruar edhe si një shqetësim?

Pyetja e tretë lidhet me pjesën e Strukturës së Posaçme së Prokurorisë së Posaçme. Pa dyshim, Struktura e Posaçme është ngritur për të luftuar pandëshkueshmërinë, sidomos në nivelet e zyrtarëve të lartë, por edhe krimin e organizuar. Pyetja ime është: a ndiheni ju të qetë sot, jo vetëm thjesht si drejtues të Prokurorisë së Posaçme, por e gjithë trupa e prokurorëve, në përmbushje të këtij misioni publik për disa çështje sensitive, të cilat nuk marrin një përgjigje ligjore? Në këtë kuadër, pavarësisht se disa nga kolegët tanë e përmendën, çfarë do të mund të bënim më mirë për të mbështetur Prokurorinë e Posaçme apo Prokurorinë e Përgjithshme, për t'i adresuar të gjitha këto çështje që lidhen edhe me pritshmëritë e publikut?

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Faleminderit!

Fjalën e ka kërkuar zoti Naço dhe më pas një anëtar nga opozita.

Nasip Naço – Faleminderit!

Duke e mbështetur zotin Kraja dhe zotin Çela, si dhe kolegët e tyre, për ushtrimin e detyrës, për përfaqësimin e akuzës, ne kërkojmë që kjo të jetë në një nivel më të lartë, pasi pritshmëria ndaj tyre si nga shoqëria civile, si nga maxhoranca, opozita apo nga klasa politike, është më e lartë.

Do të doja që dy zotërinjve t'u bëja disa pyetje.

Pyetja e parë: si janë marrëdhëniet tuaja të bashkëpunimit me Drejtorinë e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Shërbimin Informativ Shtetëror dhe me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave? A janë këto në funksion dhe a bashkëpunojnë me ju?

Pyetja e dytë: si i vlerëson institucioni juaj (pyetja sërish për të dy prokurorët) raportet periodike të Këshillit të Lartë Shtetëror, pasi në shtyp thuhet se në raport flitet për miliona euro abuzime? Raporti i KLSH-së ka pak kallëzime në dijeninë time. A studiohen nga ana juaj ato që i harron KLSH-ja dhe ju të filloni kryesisht çështje penale, se bëhet fjalë për kontrole periodike për të gjithë administratën?

Pyetja e tretë: a kanë nevojë dhe a kërkojnë mbështetje institucionet tuaja nga Kuvendi në lidhje me nenin 75 të Kodit të Procedurës Penale, pra për kompetencën lëndore, për të shtuar nene të veçanta apo për të pakësuar, pasi kemi parasysh që janë 20 prokurorë dhe 50 oficerë të BKH-së dhe, nëse e shikojmë, subjektet mund të shkojnë rreth 1 mijë -1 mijë e 500 persona gjatë ushtrimit të detyrës. Pra, a është e nevojshme ngritja e këtij institucioni për të hetuar për kaç pak persona?

Do të doja që, nëse ju kërkoni ndihmë, ne jemi të gatshëm t'ju vijmë në ndihmë për të hetuar me objektivitet dhe me paanshmëri për të pasur të gjitha mjetet e duhura ligjore. Pyetja ime është: a ka nevojë prokuroria për të ndryshuar nenin 280 të Kodit të Procedurës Penale për marrjen në dijeni të veprës penale? Në nenin 280 flitet se policia dhe prokuroria marrin dijeni për veprën penale me iniciativën e tyre dhe me njoftimin e bërë nga të tjerët. A keni nevojë ta përmirësojmë këtë nen? Do të doja një vlerësim nga të dy titullarët, pasi edhe nga raportimi juaj shikojmë që ka pak çështje të regjistruara.

E them këtë edhe për nenin 287 “Regjistrimi i veprës penale”, pra është e njëjta gjë, nëse kërkoni që, përveç kallëzimeve të bëra, të filloni me iniciativë, pasi kaq e vlerëson administrata, institucionet e pavarura, policia, ju vetë a nuk keni nevojë për më shumë mbështetje ligjore për të filluar kryesisht atë që harron policia, atë që harron maxhoranca, e harron opozita ndonjëherë? A mund të bëheni institucion i pavarur, të kërkoni edhe më shumë ndryshime në këtë drejtim?

Ju faleminderit!

Jorida Tabaku – Faleminderit, zoti Naço.

Zonja Kodheli dhe zoti Alibeaj.

Mimi Kodheli – Faleminderit, kryetare!

Meqë *check & balance* është një shtyllë e rëndësishme e funksionimit të demokracisë, nuk do të intimidohem dhe të mos bëj një pyetje, që në fakt kanë të bëjnë me një gjë, që rrjedh edhe për shkak të eksperiencës sime të mëparshme si ministre e Mbrojtjes. Ka disa dosje, për të mos thënë shumë, të dërguara aso kohe në zyrat e prokurorit të Përgjithshëm, në dijeninë time, për vepra të rënda penale, të parashikuara madje edhe në Kushtetutë, dhe që, po në gjykimin tim, nuk mund as të parashkruhen, të cilat besoj se janë mbyllur.

Pyetja ime është: ku do të mund ta merrnim këtë informacion? Nëse janë mbyllur, si janë mbyllur, kush i ka mbyllur dhe a ka përgjegjësi nëse dosjet e mbyllura, në fakt, nuk duhet të ishin mbyllur? Kjo është pyetje për ju, zoti Prokuror.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Do mundohem të jem telegrafik.

Kam një pyetje për të dy drejtuesit. Ka pasur komente nga përfaqësues të lartë politikë, Kryeministri, ministra, deputetë jashtë dhe brenda saj kësaj salle. E kuptoj që pavarësia është një

gjë, që duhet ta fitojnë institucionet e pavarura, por, sigurisht, kuptoj edhe gjënë tjetër, që pushteti politik nuk duhet të agresojë drejtësinë, qoftë edhe me deklarata. Unë do të doja të dija një opinion të secilit prej jush: a do të rekomandonit që kur ju flisni politika të heshtë, apo jo?

E dyta, kam dëgjuar raportimin e prokurorit të Përgjithshëm. A keni një zgjidhje, siç e keni menduar, për të ridimensionuar energjitë e sistemit të prokurorisë në mënyrë që edhe pozicioni juaj, por edhe i niveleve poshtë jush, të krijojë soliditetin e prokurorisë, që ajo të funksionojë me kapacitet të plotë? E keni një gjë të tillë? Nëse po, mund ta paraqisni në përgjigjen tuaj.

Për drejtuesin e SPAK-ut: a mendoni ju se keni qenë të mbingarkuar gjatë vitit 2020 prej operacionit të OFL-së? Nëse po, a është bërë kjo pengesë për vijueshmërinë normale të hetimeve dhe veprimtarisë suaj, asaj që është thelbi i kompetencës suaj, apo jo?

Pyetja e fundit është për të dy drejtuesit: cili është komenti juaj lidhur me kërkesat që ju keni bërë ndaj parlamentit apo ndaj pushtetit tjetër ekzekutiv, për plotësimin e nevojave tuaja gjatë gjithë kësaj kohe?

Së dyti, cilat janë nevojat tuaja, drejtuar njërit apo tjetrit pushtetit legjislativ apo atij ekzekutiv, në mënyrë që ritmi i veprimtarisë suaj të kthehet në pritshmëritë e publikut?

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Faleminderit!

Fjalën e kanë kërkuar zoti Koçi dhe zoti Shalsi.

Petro Koçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Çështja e parë që dua të prek është ajo e reagimit të politikës ndaj institucioneve të drejtësisë. Më vjen mirë që, pas një diskutimi që ka bërë zoti Rama publikisht, opozita ka reflektuar shumë shpejt në një formë solidare me këto institucione, sepse deri dje, me thënë të drejtën, e ka bërë fërtele SPAK-un në parlament!

Megjithatë, pyetja ime ka të bëjë me gjykimin: për çfarë kanë nevojë këto dy institucione nga Kuvendi në raport me politikën? Sepse politikës i duhen parë më shumë veprat sesa fjalët. Pra, me vepra mendoj se është bërë reforma, është mbështetur struktura me buxhet e të tjera. Megjithatë, ndoshta për shkak të përvojës që është krijuar deri tani, besoj se duhet të jetë formuluar, në gjykimin tuaj, në nevojat e mëtejshme nga politika.

Pyetja e dytë ka lidhje me Byronë Kombëtare të Hetimit, edhe ky është një institucion i ri. Unë dua të di: nga përvoja e deritanishme si është bashkëveprimi me këtë institucion? Pra, cila

është efektshmëria e këtij bashkëveprimi dhe e vetëfunksionimit të këtij institucioni, sepse në qendër të vëmendjes publike është më shumë SPAK-u, shumë pak është folur për Byronë Kombëtare të Hetimit?

Pyetja e tretë ka lidhje me kategorinë e *non grada-ve*, unë nuk po i veçoj me emra, pavarësisht se emrat kanë hierarkinë e tyre, dua të di: a përbën kjo kategori njëloj prioriteti në punën e SPAK-ut, sepse kjo është një gjë shumë e rëndësishme, pa i ndarë politikisht, por duke respektuar hierarkinë e pozitave që kanë pasur apo kanë *non grada-t* e shpallur nga SHBA-të?

Pyetja tjetër është për ministrin e Drejtësisë dhe ka lidhje me punën që bëjnë komisionet e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokuroreve: çfarë duhet bërë që raportet e këtyre komisioneve të shkojnë automatikisht te SPAK-u apo te Prokuroria e Përgjithshme? SPAK-u pretendon se vepron nëpërmjet kallëzimeve. A duhet një akt rregullator që çdo rezultat i punës së tyre për verifikimet që i bëhen prokurorëve e gjyqtarëve të shkojë automatikisht te këto institucione, pastaj ato të shikojnë, sipas raportit, nëse duhet të veprojnë, apo jo? Këto ishin pyetjet e mia.

Ju falënderoj!

Jorida Tabaku – Faleminderit!

Pyetjen e fundit e ka zoti Nasufi.

Fadil Nasufi – Faleminderit, zonja kryetare!

Jorida Tabaku – Më fal, ju kërkoj ndjesë, fjalën e ka zoti Shalsi dhe pyetjen e fundit e ka zoti Nasufi. Ju kërkoj ndjesë!

Zoti Shalsi, fjala për ju.

Eduard Shalsi – Nuk ka problem!

Nuk jam ekspert dhe njohja e kuadrit ligjor të jurisprudencës nuk është pika ime e fortë, por, në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, dua të bëj disa pyetje, por edhe rekomandim.

Zonja Çupi përmendi fjalën “eficiencë”, në fakt, në kuptimin që u përdor më shumë ishte e lidhur me efikasitetin. Sfidat e institucioneve janë dy: efikasiteti dhe efienca.

Së pari, dua t’ju përgëzoj për punën! Mendoj se do të ishte utopike që për 2,5 – 3 vjet të mendohet për rezultate të shkëlqyera për një institucion, por, gjithsesi, pyetja ka lidhje me llojet e të dhënave, që prodhojnë institucionet tuaja dhe analizat konkrete që bëhen mbi to.

Në Komisionin e Ekonomisë shpeshherë na ka dalë në pah se disa institucione, për shkak të mungesave të detajuara të punës, për shkak të mungesave së matjes së punës të

punonjësve, vijnë me kërkesat për shtesa në numër, ndërkohë që nuk janë efikasë dhe eficientë. Eficienca ka të bëjë me kostot. Logjistika, zyrat, investimi, teknologjia e informacionit, që një kolege e ridikolizoi, sot po bën revolucion edhe në sistemet e drejtësisë. Ka disa të dhëna shumë interesante, nëse do t'i shohim, për informacionin që marrin titullarët jo thjesht për numrat, por për detajet që fshihen pas atyre numrave.

Kolegët përmendën prioritetet, që është ndryshe të kapësh një punonjës të korruptuar në nivele të ulëta e të shpenzosh shumë kohë me dhjetë prej tyre dhe është ndryshe të kapësh një titullar të tyre, sepse është shumë më efikas dhe eficient si proces. Pyetja ime është: pas 2,5 vjetësh eksperiencë, kuadrin ligjor e përmendën kolegët e mi, a keni analiza të detajuara për t'i kalkuluar mirë burimet njerëzore dhe logjistikën, të cilat ju lejojnë ta bëni punën në mënyrë efikase dhe eficiente?

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Fjalën e ka zoti Nasufi.

Fadil Nasufi – Faleminderit, zonja kryetare!

Këtu kemi tre drejtues të lartë të institucioneve të drejtësisë, të cilët, në perceptimin publik, shikohen si shenjtorët që ndajnë traun se kush do të shkojnë në parajsë dhe kush do të shkojë në ferr, ndërkohë që ka edhe shumë specialistë të mirë në fushën e jurisprudencës, nga më të mirët, edhe parlamentar, por unë nuk jam i kësaj fushe. Unë dua ta shpreh shqetësimin ashtu siç është perceptimi publik, pra për reformën e drejtësisë është ky perceptim që thashë, pavarësisht rezultateve që duhet të jenë, sipas projektraporit, por edhe për disa dosje epike, që kanë gati 30 vjet që nuk po çmontohen dhe nuk janë në agjendë të pritshmërinë së publikut.

Këtu prioritet kanë dosjet e atyre që kanë humbur jetën për arsye politike apo për arsye kriminale, të vdekurit nuk bërtasin, por jemi ne të gjallët ata që duhet të ngremë zërin që këto dosje të jenë në agjendën e strukturave përkatëse të hetimit. Që të çmontohet ky lloj debati ne duhet të kontrollojmë gjuhën që të mos ndërhyjmë dhe të imponojmë në institucionet e drejtësisë, por të shprehim shqetësimin si është realisht dhe çfarë pritjet nga këto institucione.

Së dyti, përse struktura e hetimit financiar ngrihet kaq ngadalë, kur në raportin që silllet këtu dosjet që kanë të bëjnë me krimet financiare janë shumë të mëdha në shifra? Me sa shikoj aplikimet janë bërë në maj të vitit 2022, pra struktura ka nevojë të plotësohet me personelin përkatës, i cili duhet rekrutuar sipas ligjit.

E treta, që doli edhe nga kolegët e tjerë, në organet e drejtësisë nëpërmjet vetingut janë bërë spastrime dhe është lënë me kaq. Cili është perceptimi? Perceptimi është ky: ndryshimi i statusit të gjithkujt që ka funksione publike, të cilët largohen dhe në sytë e publikut janë me pasuri, pavarësisht se si klasifikohen ato në gjuhën penale dhe juridike. Këto çështje duhet të jenë çështje të kallëzimit, por si zgjidhen? Ato zgjidhen duke bashkëpunuar, për shembull, organet e vetingut të bëjnë kallëzime, ILDKPI-ja të bëjë kallëzime e të tjera me radhë, që të kalojnë nga spastrimi direkt te dënimi, sipas ligjeve në fuqi.

Faleminderit!

Jorida Tabaku – Faleminderit, zoti Nasufi!

Ju kërkoj ndjesë, nuk ishte pyetja e fundit. Fjalën e ka zoti Gogu, i cili shkurtimisht do të bëjë pyetjet e fundit.

Toni Gogu – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë kam tre pyetje dhe i kam për të dy prokurorët e nderuar.

Pyetja e parë është për të dy prokurorët në lidhje me objektivat tuaj strategjike, jam i interesuar të kuptoj se çfarë metodologjie dhe çfarë parametrash do të përdorni për të matur suksesin e përmbushjes së objektivave tuaj strategjike?

Pyetja e dytë dhe nënpyetja e saj ka të bëjë me drejtuesin e SPAK-ut. Zoti prokuror, në raportimin tuaj përmendët marrëveshjen që keni lidhur me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit të Konfliktit të Interesave dhe Pasurive. Dua të di: çfarë synon marrëveshja, nëse nuk ka ndonjë sekret?

E dyta, a parashikon kjo marrëveshje dorëzimin e kallëzimeve që inspektorati ka bërë në prokurorinë e Tiranës ndaj ish-gjyqtarëve e prokurorëve, meqenëse është një pikë shumë e rëndësishme e matjes së progresit të Shqipërisë në integrimin europian?

Jorida Tabaku – Të nderuar kolegë, mendoj se patëm një grup shumë të gjerë pyetjesh.

Falënderoj përfaqësuesit e institucioneve!

Stafi dhe sekretariati do të zbardhin të gjithë pyetjet dhe komentet, për të cilat do të organizojmë një seancë tjetër.

Falënderoj zotin Manja që erdhi, por interesi ishte për dy institucionet e drejtësisë!

Unë besoj se ka akoma shumë pyetje të tjera, të cilat do t'i vazhdojmë dhe do t'i çojmë përpara në një seancë tjetër, bashkë me drejtuesit e KLP-së dhe KLGJ-së.

Për mua lajmi i mirë në këtë takim ishte se 80% e rasteve që po heton SPAK-u as që nuk e dinë se po hetohen!

Shpresojmë të kemi përmbushje të objektivit që vendoset në progresraport për sa i preket hetimit të zyrtarëve të lartë! Unë inkurajoj çdo institucion drejtësie që të prekë pushtetin. Njerëzit me pushtet përpara drejtësisë janë lajmi më i mirë dhe Shqipëria është gati për procesin e integritetit.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretare e Këshillit

Joana Allushi

Përgjegjësjë e Shërbimit të Redaktorëve

Euzheni Pengili